

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Përmbajtja:

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES	
DHE TË ARDHURA TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E FLUKSESVE TË PARASË	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-56

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2017 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e Opinionit

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përkrahur në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Bankës, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera,
Tirana, Shqipëri
Numër identifikimi unik i subjektit (NUIS): L41709002H



Enida Cara
Auditues ligjor
Partner angazhimi

Tiranë, Shqipëri
17 prill 2018

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktive			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	9	3,517,936	2,965,941
Teprica të kushtëzuara me Bankën Qendrore	10	530,747	486,424
Investime me banka dhe institucione financiare	11	-	234,253
Mudaraba - fonde investimi	12	50,321	77,404
Bono thesari të mbajtura deri në maturim	13	-	-
Murabaha - të arkëtueshme financiare	14	4,010,307	3,325,689
Aktive të marra nga procese ligjore	15	285,608	236,518
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara e patrupëzuara	16	172,384	184,983
Tatim fitimi i parapaguar		11,048	6,651
Aktive të tjera	17	16,026	13,763
Totali i Aktiveve		8,594,377	7,531,626
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	18	692,975	624,061
Hua nga institucioneve financiare	19	217,484	170,832
Detyrime ndaj klientëve	20	6,270,941	5,176,179
Detyrime të tjera	21	13,811	8,218
Fonde Rezervë	21	32,644	22,568
Totali i Detyrimeve		7,227,855	6,001,858
Kapitali			
Kapitali aksionar	22	1,762,717	1,762,717
Rezervat	22	109,033	97,929
Humbje e mbartur		(505,228)	(330,878)
Totali i kapitalit		1,366,522	1,529,768
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		8,594,377	7,531,626

Pasqyrat Financiare të Bankës u aprovuan nga Këshilli Drejtues më 9 prill 2018 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Muhamed Prlja
Drejtor i Përgjithshëm



Zinaida Musaj
Drejtoreshë e Departamentit të Financës

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 5 deri në 56, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në'000 Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga operacionet bankare	23	253,818	230,825
Shpenzime për shpërndarjet e fitimit për depozituesit	24	(55,593)	(47,649)
Të ardhurat neto nga veprimet bankare		198,225	183,176
Të ardhura nga komisione dhe tarifa, neto (Humbja)/Fitim neto nga kursi i këmbimit	25	26,675 (194,118)	21,588 43,503
Të ardhura të tjera		80,486	4,597
Totali i (shpenzimeve)/ të ardhurave të tjera neto nga veprimet bankare		(86,957)	69,688
Rimarrje neto nga zhvlerësimi për arkëtimet financiare Murabaha	11	10,923	52,613
Humbje nga zhvlerësimi i fondeve të investimit, Mudaraba	9	(17,683)	(19,351)
Fitim nga shitja e pronave		-	1,123
Fonde të tjera rezervë		(4,952)	(5,162)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	13	(21,890)	(22,558)
Shpenzime personeli	26	(109,454)	(106,730)
Shpenzime për qiratë operative		(19,821)	(19,640)
Shpenzime të tjera administrative	27	(111,637)	(90,806)
Totali i shpenzimeve operative		(274,514)	(210,511)
(Humbja)/Fitimi neto para tatimit		(163,246)	42,353
Tatim fitimi	28	-	(11,307)
(Humbja)/Fitimi neto e vitit		(163,246)	31,046
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse pas tatimit		-	-
Totali i (humbjeve)/te ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(163,246)	31,046

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 5 deri në 56 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek)

		Viti i mbyllur më Shënime 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
(Humbja)/Fitimi përpara tatimit mbi të ardhurat		(163,246)	42,353
<i>Rakordimet për zërat jomonetarë</i>			-
Humbje nga zhvlerësimi neto të aktiveve financiare			
Murabaha	14	(10,923)	(52,613)
Ndryshim në fondin e investimit Mudaraba	12	27,083	17,554
Zhvlerësimi dhe amortizimi	16	21,890	22,558
Të ardhura nga operacionet bankare		(253,818)	(230,825)
Shpenzime për shpërndarjet e fitimit për depozituesit		55,593	47,649
Ndikimi nga efekti i kursit të këmbimit tek paraja dhe ekuivalentë të saj		205,647	(43,503)
		(117,774)	(196,827)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative::</i>			
Rritje në të arkëtueshmet financiare - Murabaha		(764,627)	(989,114)
Pakësim në aktivet e tjera		31,367	34,133
Pakësim në tepricat me institucionet financiare		189,930	209,772
Rritje në llogaritë e klientëve		1,088,638	595,765
Rritje në detyrimet ndaj bankave		115,566	672,952
Rritje/(Pakësim) në detyrimet e tjera		15,669	(35,076)
		558,769	291,605
Tatim fitimi i (paguar)/arkëtuar		(4,396)	-
Të ardhura të arkëtuara nga aktivitetet bankare		262,029	223,848
Shpenzime të paguara për depozituesit		(49,469)	(45,052)
Flukset neto të parasë të gjeneruara nga aktivitetet operative		766,933	470,401
Flukset të parasë nga aktivitetet investuese			
Të ardhura nga bonot e thesarit		-	298,540
Blerje të pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara	16	(9,291)	(9,063)
Flukset neto të parasë nga aktivitetet investuese		(9,291)	289,477
Flukset të parasë nga aktivitetet financuese			
Rritje në detyrimet ndaj bankave		-	-
Flukset neto të parasë nga aktivitetet financuese		-	-
Rritje neto në para dhe ekuivalentet e saj		757,642	759,878
Ndikimi nga efekti i kursit të këmbimit tek paraja dhe ekuivalentë të saj		(205,647)	43,503
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit		2,965,941	2,162,560
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	6	3,517,936	2,965,941

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 5 deri në 56, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000Lek)

	Kapitali aksionar	Rezervat	Humbje të mbartura	Totali
Teprica më 1 janar 2016	1,762,717	88,929	(352,924)	1,498,722
Transferim në Rezerva	-	9,000	(9,000)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-
Fitimi neto për vitin	-	-	31,046	31,046
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	31,046	31,046
Teprica më 31 dhjetor 2016	1,762,717	97,929	(330,878)	1,529,768
Transferim në Rezerva	-	11,104	(11,104)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-
Humbja neto për vitin	-	-	(163,246)	(163,246)
Humbja totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(163,246)	(163,246)
Teprica më 31 dhjetor 2017	1,762,717	109,033	(505,228)	1,366,522

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 5 deri në 56, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shenime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur percaktohet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

(a) Njësia raportuese

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (referuar më poshtë si “Banka” ose “UBA”) është krijuar në Shqipëri për të zhvilluar veprimtari bankare në përputhje me legjislacionin shqiptar. Bazuar në nenet e Statutit të saj, Banka ndjek Parimet Sharia. Aktivitetet e Bankës përfshijnë veprimtarinë si administruese, mbi bazën e mirëbesimit, të fondeve të investuara në përputhje me parimet dhe ligjet Islamike. Banka është subjekt i Ligjit Nr. 9662 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006 dhe nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë.

Në 5 nëntor 1992, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare. Procedurat e regjistrimit përfunduan në 1 korrik 1994, data e themelimit. Në 11 janar 1999, në përputhje me Vendimin Nr.165, të datës 11 dhjetor 1998 të Bankës së Shqipërisë, Banka mori licencën “Për vazhdimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Ligjin Nr. 8365, të datës 2 korrik 1998 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Struktura aksionare e regjistruar ishte si më poshtë :

Banka Islamike për Zhvillim, Jeddah (IDB)	86.7%
Ithmar Bank B.S.C	4.63%
Dallah Albaraka Holding Co	2.32%
Investitorë të tjerë	6.35%

Qendra e Bankës është vendosur në Tiranë. Aktualisht Banka ka një shpërndarje të aktivitetit në 4 degë në qytetet Tiranë, Shkodër, Fier dhe Durrës si dhe ka dy agjenci të vendosura në Tiranë. Më 31 dhjetor 2017, Banka ka të punësuar 79 punonjës (2016: 77 punonjës).

(b) Vlerësimi i menaxhimit për aftësinë për vazhdimësi të aktivitetit

Banka ka pësuar humbje gjatë viteve të fundit financiarë, dhe fitim në vitin aktual. Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e kapitalit minimal, të limitohen risqet nga ekspozimet e mëdha dhe për të vazhduar aktivitetin, aksionarët rishikojnë vazhdimisht nevojën për të rritur kapitalin.

Pas kësaj analize dhe injektiveve të kryera të kapitaleve, Drejtimi beson që aftësia e Bankës për të vazhduar aktivitetin nuk do të cënohet. Për këtë arsye, Banka i ka përgatitur këto pasqyra financiare bazuar në parimin e vazhdimësisë së aktivitetit.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK').

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostove historike, me përjashtim të fondeve të investimit Mudaraba, të cilat janë matur me vlerë të drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe prezantuese

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Monedhën Shqiptare ('Lek'), që është dhe monedha funksionale e Bankës. Përveçse kur tregohet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që manaxhimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që prekin aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet për vlerësimet kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën është kryer vlerësimi dhe në çdo periudhë të ardhshme që mund të prekë.

Informacioni për çështjet kryesore të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël, që kanë efekt domethënës mbi shumat e njohura në pasqyrat financiare paraqiten në shënimin 5.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Banka ka zbatuar në mënyrë konsistente standardet kontabël të përkrahura më poshtë për të gjithë periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksione të këmbimit valutor

Transaksionet në monedhë të huaj janë të këmbyerë në monedhën respektive funksionale të veprimit me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit, janë të këmbyerë në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në atë datë. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit mbi zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj e këmbyer me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në fund të periudhës.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, që janë të paraqitura me kosto historike, janë të këmbyerë me kursin zyrtar të këmbimit të datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë janë të këmbyerë në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën që është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat nga monedhat e huaja që lindin nga ndryshimet në kursin e këmbimit njihen në pasqyrën e fitim / humbjes.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Të ardhura dhe shpenzime nga aktivitetet bankare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga veprimet bankare janë të njohura në fitim ose humbje duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv. 'Norma e interesit efektiv' është norma që aktualizon në mënyrë të saktë pagesat e ardhshme dhe të arkëtueshmet në para gjatë jetës së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është më e përshtatshme në një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur llogaritet norma e interesit efektiv, Banka vlerëson rrjedhjet e ardhshme të parasë duke konsideruar të gjithë termat kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Përlllogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe pikët e paguara ose të marra që janë një pjesë e rëndësishme e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga veprimet bankare të paraqitura në fitim ose humbje përfshijnë të ardhura mbi aktivitet dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të përlllogaritur mbi bazat e normës efektive të interesit.

Të ardhurat dhe shpenzimet në të gjithë aktivitet dhe detyrimet tregtare konsiderohen të rastësishme ndaj veprimeve tregtare të Bankës, dhe janë të paraqituara më vete.

(i) Shpërndarja e fitimit për klientët

Shpërndarja e fitimit për klientët nga depozitat e vendosura në Banke i shpërndahet depozituesve në përputhje me parimet Sharia duke shpërndarë fitimin nga depozitat e riinvestuara. Pagesat i kalohen depozituesve dhe ngarkohen në llogarinë e klientit në përputhje me maturitetet kontraktuale të depozitave. Për shërbimin e mirëmbajtjes së ofruar nga Mudarib aplikohet edhe një shumë e caktuar komisioni. Shpërndarja e fitimit nga transaksionet Mudarabah paguhet dhe paraqitet neto nga komisioni Mudarib.

(ii) Të ardhurat nga veprimet bankare

Të ardhurat nga veprimet bankare përfshirë të ardhurat nga transaksionet Murabaha dhe të ardhurat nga bankat dhe institucione të tjera financiare janë të njohura në fitim ose humbje duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

Të ardhurat nga kontratat Mudaraba njihen në fitim ose humbje kur bankës i jepet e drejta e këtij fitimi. Çdo humbje për periudhën është njohur deri në shumën kur këto humbje zbriten nga kapitali i Mudaraba. Shikoni politikat kontabël 3(j).

(c) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifën dhe komisionet që janë të rëndësishme për normën e interesit efektiv mbi aktivitet dhe detyrimet financiare janë të përfshira në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga tarifën dhe komisionet, duke përfshirë komisionet e mirëmbajtjes së llogarisë, komisionet e menaxhimit të investimeve dhe komisionet e vendosjes njihen në momentin në të cilin kryhet shërbimi.

Shpenzime të tjera të tarifave dhe komisioneve lidhen kryesisht me komisione transaksionesh dhe shërbimesh, të cilat kalohen në shpenzime sapo kryhet shërbimi.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Pagesat e qirasë

i. Pagesat e qirasë - qiramarrësi

Pagesat e bëra për kontrata qiraje operative janë të njohura në fitim ose humbje në baza lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë. Stimujt e qirasë janë të njohur si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë, përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

ii. Aktivet e qirasë - qiradhënësi

Nëse Banka është qiradhënësi në një marrëveshje qiraje dhe që në thelb ka për qëllim transferimin e të gjithë rreziqeve dhe përfitimeve të rastësishme tek pronësia e aktivit të marrë me qira nga qiramarrësi, atëherë marrëveshja klasifikohet si qira financiare dhe një e drejtë e arkëtueshme njihet e barabartë me investimin neto për qiranë dhe paraqitet brenda llogarive të arkëtueshmeve financiare Murabaha. Shikoni politikat kontabël 3(h).

(e) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

i. Tatimi aktual

Tatimi aktual përbën tatimin që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Shuma e tatimit aktual të pagueshem apo të arkëtueshem është vlerësimi më i mirë i tatimit të pritshëm për tu paguar apo arkëtuar i cili pasqyron çdo pasiguri në lidhje me tatimin mbi fitimin, gjithmonë nëse ka pasiguri të tilla. Tatimi mbi fitimin matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e raportimit.

ii. Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore.

Aktivet tatimore të shtyra janë njohur për humbjet tatimore të papërdorura, kreditimet tatimore të papërdorura, dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën në të cilën është e mundur që fitimet e ardhshme të tatueshme do të realizohen në mënyrë që ato të mund të përdoren kundrejt tij. Fitimet e ardhshme të tatueshme janë përcaktuar mbi bazën e planeve të biznesit të Bankës dhe rimarrjes së diferencave të përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën në të cilën përcaktohet se nuk është më e mundur që përfitimi nga tatimi do të realizohet.

Aktivet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën në të cilën është e mundur që fitimet e ardhshme të tatueshme do të realizohen në mënyrë që ato të mund të përdoren kundrejt tij.

Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që konsiderohen si të tilla në datën e raportimit. Detyrimet dhe aktivet tatimore të shtyra do të netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet korrente tatimore përkundrejt aktiveve korrente tatimore dhe nëse ato lidhen me tatimin mbi fitimin të mbledhur nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtën njësi tatimore, ose në njësi të ndryshme tatimore të cilat kanë si qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet e tyre korrente tatimore në baza neto ose aktivet dhe detyrimet e tyre tatimore do të realizohen njëkohësisht.

iii. Ekspozimi tatimor

Në përcaktimin e vlerës së tatim fitimit aktual dhe të shtyrë Banka merr parasysh impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse mund të ketë taksa dhe interesa shtesë të pagueshme. Banka beson se përlllogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore, bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në llogaritje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

iii. Ekspozimi tatimor (vazhdim)

Informacion i ri mund të jetë në dispozicion dhe mund të shkaktojë që Banka të ndryshojë gjykimet në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të kenë impakt mbi tatim fitimin në periudhat që ky përcaktim bëhet.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të realizohet, në mënyrë që ato të mund të përdoren kundrejt tij. Aktivit tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet nëse nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

(f) Aktivitet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njihet të arkëtueshmet financiare, depozitat dhe llogaritë investuese në datën në të cilën ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit në të cilën Banka zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tij për ato aktive ose detyrime financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Klasifikimi

Banka i klasifikon aktivet e saj financiare në njërin prej kategorive të mëposhtme:

- huatë dhe llogaritë e arkëtueshme
- aktive financiare të mbajtura deri në maturim

Shiko politikat kontabël 3 (i), dhe (j).

(iii) Çregjistrimi

Aktivitet financiare

Banka çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj rrjedhave të parasë që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo transferon aktivin financiar me një transaksion kur të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar janë transferuar, ose në ato raste kur Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar dhe nuk mban kontroll mbi aktivin financiar. Çdo interes mbi aktivet financiare të transferuara që plotësojnë kushtet për mosnjohje, i cili është krijuar apo përfituar nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar. Në çregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivit (ose vlerës kontabël që i takon pjesës së transferuar të aktivit) dhe shumës së arkëtuar dhe çdo fitim apo humbje e akumuluar që është njohur në të ardhurat gjithëpërfshirëse do të njihet në fitim ose humbje.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi në këmbim të aktiveve, transaksioni konsiderohet si një transaksion i financimit nëpërmjet letrave me vlerë, i ngjashëm me transaksionet e riblerjes, pasi ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet.

Në transaksionet ku Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar dhe për rrjedhojë vazhdon të ketë kontrollin mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së saj në vazhdim, që përcaktohet nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivit të transferuar.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi (vazhdim)

Në disa transaksione Banka mban detyrimin për t'i shërbyer aktivitetit financiar të transferuar përkundrejt një tarife. Aktivi i transferuar do të çregjistrohet kur plotësohen kriteret e mosnjohjes. Një aktiv apo detyrim financiar njihet si pjesë e kontratës së shërbimit, në varësi të faktit nëse tarifa e shërbimit është mëse e përshtatshme (aktiv) ose është më pak e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimit.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale përfundojnë, anulohen ose i mbaron afati.

(iv) Netimi

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe vlera e tyre neto të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohen nga SNRF-të, ose për fitime dhe humbje të lindura nga një grup transaksionesh të ngjashme si në rastin e aktiviteteve tregtare të Bankës.

(v) Matja e kostos së amortizuar

'Kostoja e amortizuar' e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilin aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e kështit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, ndërmjet pjesëmarrësve në treg në një transaksion të zakonshëm, në datën e matjes në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton riskun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg shikohet si aktiv nëqoftëse transaksioni për një aktiv ose detyrim ndodh me një shpeshtësi dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion për çmimet në vazhdimësi. Në qoftë se për një instrument financiar nuk ka çmim në treg aktiv, Banka vendos duke përdorur teknika të vlerësimit për vlerën e drejtë duke maksimizuar përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme dhe minimizuar përdorimin e të dhënave jo të vëzhgueshme. Teknikat e zgjedhura të vlerësimit përfshijnë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg, marrin parasysh në përcaktimin e çmimit në një transaksion.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të instrumentit financiar në njohjen fillestare, është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, dhe vlera e drejtë nuk mbështetet as nga çmimi i kuotuar, dhe as nga një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna të vëzhgueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerë të drejtë dhe pastaj rregullohet për diferencën mes vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më vonë kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në baza të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se vlerësimi të jetë mbështetur plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të jetë mbyllur.

Nëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerë të drejtë ka një çmim të kërkuar dhe të ofruar, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmim të ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me një çmim të kërkuar.

Vlera e drejtë e depozitave rrjedhëse nuk është më pak sesa shuma që do paguhej në të pare, e aktualizuar që nga dita e parë në të cilën kjo shumë do të kërkohej të paguhej.

Banka njih transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në datën e fundit të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse ka evidencë objektive që tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në rrjedhat e ardhshme të parasë të aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare (duke përfshirë letra me vlerë) duhen zhvlerësuar mund të përfshijë:

- vështirësi financiare domethënëse të huamarrësit ose të emetuesit,
- mospagim ose shkelje nga një huamarrës,
- ristrukturim të një të drejte të arkëtueshme financiare nga Banka me terma që Banka nuk do t'i konsideronte në kushte të tjera,
- treguesit që huamarresi ose emetuesi do të falimentojë,
- zhdukje të një tregu aktiv për një letër me vlerë,
- ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme të lidhura me një grup aktivesh siç janë ndryshimet e pafavorshme të aftësive paguese të huamarrësit ose të huadhënësit në Bankë apo kushtet ekonomike që përkojnë me rritje të mospagesave në Bankë. Ndërsa për investimet në letra me vlerë, një rënie domethënëse ose e tejjgatur e vlerës së drejtë nën kosto, është një evidencë objektive e zhvlerësimit.

Banka konsideron evidencën e zhvlerësimit për huatë, investimet Mudaraba dhe investimet e mbajtura deri në maturim si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha huatë, paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen individualisht për zhvlerësim specifike.

Aktivët, të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar së bashku huatë, investimet Mudaraba dhe investimet e mbajtura deri në maturim me karakteristika të ngjashme rreziku.

Ato aktive financiare jo specifiku të zhvlerësuar vlerësohen në mënyrë kolektive për çdo zhvlerësim të ndodhur por edhe të paidentifikuar. Huatë, parapagimet dhe investimet nëpërmjet letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar së bashku huatë, parapagimet dhe investimet nëpërmjet letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim me karakteristika të ngjashme rreziku.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Komponenti individual i totalit të zbritjes për zhvlerësim i cili zbatohet mbi një aktiv financiar vlerësohet individualisht për zhvlerësim, sikundër është evidentuar të jetë zhvlerësuar individualisht, është bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të vlerës aktuale të rrjedhës së parasë që priten të arkëtohen. Në llogaritjen e këtyre flukseve drejtimi kryen gjykime mbi situatën financiare të debitorit dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij dhe strategjisë së rikuperimit dhe parashikimin që rrjedhat e parasë që konsiderohen të arkëtueshme janë të miratuara në mënyrë të pavarur nga funksioni i rrezikut të kredisë.

Një komponent kolektiv i totalit të zbritjes për zhvlerësim është krijuar për:

- grupet e huave homogjene që nuk konsiderohen individualisht si të rëndësishme
- grupet e aktiveve të cilat janë individualisht të rëndësishme por që nuk janë të zhvlerësuara individualisht (humbje 'e ndodhur por jo e raportuar')

Zbritja kolektive për zhvlerësimi për grupet homogjene të huave është krijuar duke përdorur metoda statistikore që lidhen me metodologjinë e normave të mospagimit ose, për portofolet e vogla për të cilat informacioni është jo i plotë, përdoret një formulë e cila bazohet mbi eksperiencën e normave historike të humbjes. Metodologjia e bazuar mbi normat e mospagimit përdor analiza statistikore të të dhënave historike që lidhen me pamundësinë për të matur shumën e humbjes së ndodhur. Drejtimi zbaton gjykimin për tu siguruar që vlerësimi i humbjes i bazuar në informacionin historik i cili është rregulluar atë mënyrë me qëllim pasqyrimin e kushteve ekonomike dhe miksit e produkteve. Normat e mospagimit dhe normat e humbjes janë vazhdimisht të krahasueshme me humbjet aktuale.

Zbritja për zhvlerësim e ndodhur por jo e raportuar mbulon humbjet kreditore të qenësishme në portofolet e të arkëtueshmeve financiare Murabaha dhe investimeve në letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor kur ekziston një evidencë objektive që sugjerojnë që megjithëse ato përmbajnë zëra të zhvlerësuar, zhvlerësimi individual i këtyre zërave nuk mundet ende të identifikohet.

Zbritja për zhvlerësim e ndodhur por jo e raportuar është i bazuar në normat e humbjes historike, të rregulluara me qëllim pasqyrimin e kushteve aktuale ekonomike duke ndikuar në portofolin. Ai paraqet supozimet e bëra në lidhje me humbjen e shfaqur përgjatë periudhës - p.sh. periudha ndërmjet ngjarjes së ndodhjes dhe identifikimit të një humbjeje të ndodhur. Drejtimi përlllogarit një humbje periudhe për secilin prej portofoleve të identifikuar dhe më pas i teston këto përlllogaritje kundrejt përvojës së kaluar. Faktorët të cilët mund të ndikojnë në humbjen e shfaqur të periudhës përfshijnë kushtet ekonomike dhe të tregut, sjelljen konsumatore, informacionin e drejtimit mbi portofolin, procesin e menaxhimit dhe përvojës me grumbullimin e kredive.

Në vlerësimin e zbritjeve të humbjeve kolektive nga zhvlerësimi, drejtimi konsideron faktorët e tillë si cilësia e huasë, madhësia e portofolit dhe faktorët ekonomik. Për të matur zbritjen për zhvlerësim të kërkuar, supozimet janë kryer për të përcaktuar se si janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar, bazuar në përvojën historike dhe kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e matur e zbritjes për zhvlerësim varet nga supozimet e kryera për modelin dhe parametrat e përdorur në përcaktimin e zbritjes kolektive për zhvlerësim.

Matja

Humbjet nga zhvlerësimi mbi aktivet të vlerësuara me koston e amortizuar janë përlllogaritur si diferencë ndërmjet vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të fluseve rrjedhëse të parasë të aktualizuara me normën e interesit efektiv të aktivit përkatës.

Nëse kushtet e një aktivi financiar rinegociohen apo ndryshohen apo nëse një aktiv financiar ekzistues zëvendësohet me një aktiv financiar të ri për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit atëherë një vlerësim kryhet për të konsideruar nëse aktivi financiar duhet çregjistruar. Nëse rrjedhat e parasë së aktivit financiar kushtet e të cilit u rinegociovan janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për arkëtimin e rrjedhave të ardhshme të parasë nga aktivi financiar ekzistues konsiderohen si jashtë afatit të marrëveshjes. Në këtë rast aktivi financiar ekzistues çregjistrohet dhe në të njëjtën kohë aktivi i ri financiar njihet me vlerën e drejtë.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Humbja nga zhvlerësimi përpara një ristrukturimi të pritshëm matet si vijon:

- Nëse ristrukturimi i pritshëm nuk do të rezultojë në një çregjistrim të aktivitetit ekzistues, atëherë rrjedhat e vlerësuarat të parasë që rrjedhin nga aktiviteti financiar i ndryshuar përfshihen në matjen e aktivitetit ekzistues bazuar në shumat dhe kohën e pritjes të tyre të aktualizuara me normën efektive të interesit të aktivitetit financiar ekzistues.
- Nëse ristrukturimi i pritshëm do të rezultojë në një çregjistrim të aktivitetit ekzistues, atëherë vlera e drejtë e pritshme e aktivitetit të ri trajtohet si rrjedha përfundimtare e parasë së ardhur nga aktiviteti ekzistues në momentin e çregjistrimit të tij. Kjo shumë aktualizohet për periudhën e kohës nga data e pritshme e çregjistrimit deri në datën e raportimit duke përdorur normën efektive të interesit të aktivitetit ekzistues.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari zbritje për zhvlerësim të kundërt me llogarinë e huave, llogarive të arkëtueshme dhe investimeve në letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim. Intersi mbi aktivitetin e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes një norme të zbritshme të pandryshueshme. Nëse një ngjarje ndodh pas momentit në të cilin zhvlerëimi është njohur duke shkaktuar një ulje të shumës së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë ulja në humbjen nga zhvlerësimi rimerret përmes fitimit apo humbjes.

Humbjet nga zhvlerësimi mbi një investim në letra me vlerë të mbajtura për shitje njihen duke i riklasifikuar humbjet e akumuluarat në rezervën e vlerës së drejtë nga kapitali për në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Humbja e akumuluar që është riklasifikuar nga kapitali për në fitim/humbje është diferenca ndërmjet kostove të blerjes, në terma neto nga çdo pagesë kryesore dhe amortizimi dhe vlerës aktuale të drejtë, pakësuar me çdo humbje nga zhvlerësimi dhe të njohur më parë në fitim humbje. Ndryshimet në zhvlerëim të cilat i atribuohen zbatimit metodës së interesit efektiv janë pasqyruar si një përbërës i të ardhurave nga interesi.

Rimarrjet e zhvlerësimit dhe çregjistrimet e tij

Nëse në një periudhë pasardhëse, vlera e drejtë e një letre me vlerë të mbajtur për shitje, e cila është zhvlerësuar, rritet dhe rritja e vlerës së drejtë mund të lidhet saktësisht me një ngjarje të ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur, atëherë në këtë moment humbja nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit apo humbjes; përndryshe, çdo rritje në vlerën e drejtë njihet në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Çdo përmirësim i mëtejshëm në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të mbajtur për shitje, e cila është e zhvlerësuar, njihet gjithmonë në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Banka çregjistron një llogari të arkëtueshme financiare apo një investim në letër me vlerë, pjesërisht ose tërësisht, dhe çdo zbritje për humbje nga zhvlerësimi, atëherë kur departamenti i huave të Bankës përcakton se nuk ka më asnjë mundësi reale për akëtimin e shumës përkatëse.

(g) Paraja dhe ekuivalente të saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj të ngjashme përfshijnë tepricën e arkës, teprica të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet fillestar tre muaj ose më pak duke filluar që nga data e blerjes së aktivitetit, të cilat janë objekt i një rreziku jodomethënës të ndryshimeve në vlerë të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj me të mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuara.

(h) Llogaritë e arkëtueshme financiare Murabaha

Llogaritë e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuarat në një treg aktiv dhe që Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në mënyrë të menjëhershme ose brenda një afati kohor të shkurtër.

Llogaritë e arkëtueshme financiare Murabaha kundrejt bankave janë klasifikuar si hua ose drejta të arkëtueshme të cilat përfshijnë:

- ato të klasifikuara si hua apo të drejta të arkëtueshme
- të arkëtueshme nga qiraja financiare

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(h) Llogaritë e arkëtueshme financiare Murabaha (vazhdim)

Të arkëtueshmet financiare të matura fillimisht me vlerë të drejtë plus kostot shtesë direkte të transaksionit, do të maten në vijim me kostot e tyre të amortizuara duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

Huatë dhe parapagimet përfshijnë gjithashtu të arkëtueshmet nga qiraja financiare në të cilën Grupi është në pozicionin e qiradhënësit (shiko politikat kontabël 3. D(ii)).

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim të caktuar në një datë të ardhshme ("marrëveshje të riblerjes të anasjellta"), marrëveshja kontabilizohet si e arkëtueshme financiare, dhe aktivi nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

(i) Investimet në letrat me vlerë

Investimet njihen fillimisht me vlerë të drejtë, dhe në rastin e letrave me vlerë jo nëpërmjet fitim/humbjes, plus kostot e transaksioneve direkte, dhe për pasojë rregjistrohen në klasifikimet e tyre si investime në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim, të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes dhe investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje.

Të mbajtura deri në maturim

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturitet të përcaktuar, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje.

Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në rastet e shitjes ose riklasifikimit përpara maturimit të një pjese të konsiderueshme të investimeve që mbahen deri në maturim në kategorinë e atyre të vlefshme për shitje, dhe kjo do ta pengonte Bankën të klasifikonte investimet si të mbajtura deri në maturim, gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

Gjithësesi, të ardhurat nga shitja dhe riklasifikimet në çdonjërin prej situatave të mëposhtme nuk do të përbënte shkak për një riklasifikim:

- të ardhurat nga shitja apo riklasifikimet që janë në prag të datës së maturimit e cila ndryshon në bazë të normave të tregut për interesin;
- nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në vlerën e drejtë të aktivit financiar;
- të ardhurat nga shitjet ose riklasifikimet pasi Banka ka mbledhur kryesisht të gjithë principalin origjinal të aktivitetit; dhe
- të ardhurat nga shitja apo riklasifikimet të cilat i atribuohen ngjarjeve të izoluara, të cilat nuk përsëriten dhe janë praktikisht jashtë kontrollit të Bankës, nuk mund të parashikohen në një mënyrë të arsyeshme.

(j) Investimet në Mudaraba

Investimet në Mudaraba janë ortakëri, me anë të së cilave Banka është në rolin e investitorit që siguron kapitalin për sipërmarresin ('Mudarib') me qëllim që ky i fundit të marrë përsipër (menaxhojë) aktivitetin e investimit. Investimi në Mudaraba njihet fillimisht me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë e investimit Mudaraba është çmimi që do të merret nga shitja e aktiveve në një transaksion të rregullt, pa zbritur kostot e transaksionit. Vlera e drejtë e investimit në Mudaraba përcaktohet bazuar në raportet e vlerësuesve të pavarur, të cilët mbajnë një kualifikim profesional të njohur dhe përkatës dhe kane ekspërience aktuale në vlerësimin e pronave në kategori dhe vendodhje të ngjashme. Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka apo jo evidence objektive që investimet janë të zhvlerësuara dhe rregullon tepricën mbyllëse me zhvlerësimin përkatës.

(k) Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe detyrimet e varura

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe detyrimet e varura janë për Bankën, burimet e financimit të borxhit.

Kur një Bankë shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në marrëveshje për riblerjen e aktivitetit (ose aktivi të ngjashëm) me një çmim fikse në një datë të ardhshme ("marrëveshje e riblerjes dhe rishitjes"), marrëveshja kontabilizohet si detyrim, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe detyrimet e varura (vazhdim)

Banka i klasifikon instrumentat e kapitalit si detyrime financiare apo si instrumenta të kapitalit në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit. Aksionet preferenciale të konvertueshëm të Bankës ofrojnë kupona jo diskrecional dhe janë të konvertueshëm nga mbajtësi i tyre dhe për këtë arsye përshihen tek detyrimet e varura.

Depozitat, letrat me vlerë të emetuara të borxhit dhe detyrimet e varura maten fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksioneve shtesë, dhe në vijim maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveçse kur Banka vendos të mbajë detyrimet në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Depozitat e klientëve përfshijnë depozita investimi për të cilat depozituesit udhëzojnë Bankën për të investuar fondet e tyre në investime të veçanta ose me kushte të paracaktuara. Këto depozita investohen nga Banka nën emrin e saj nën kushtet e kontratave specifike Mudarib të nënshkruara me depozituesit. Këto depozita specifike investuese, të cilat janë të klasifikuara brenda llogarive të klientëve, ndarjen fitimin ose humbjen direkte të investimeve të tyre përkatëse në momentin e realizimit dhe në rast të kundërt nuk ndajnë fitimin ose humbjen e Bankës.

(l) Aktive të marra nga proceset ligjore

Aktive të marra nga proceset ligjore përfaqësojnë pronat e fituara nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit mbi të arkëtueshmet financiare. Këto aktive klasifikohen si të mbajtura për shitje në qoftë se vlera kontabël neto do të mbulohet kryesisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje dhe jo nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm dhe shitja është shumë e mundshme nëse vlera e tyre kontabël do të mbulohet kryesisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje dhe jo përmes përdorimit të vazhdueshëm. Ky kusht konsiderohet si i përmbushur vetëm kur aktivi (ose grupi i shitur) është i disponueshëm për shitje të menjëhershme në gjendjen e tanishme, duke u nënshtruar vetëm kushteve që janë të zakonshme dhe standarte për shitjet e aktiveve të tilla (ose grupit të shitur) dhe shitja e tij është shumë e mundshme. Drejtimi duhet të angazhohet për shitjen, e cila pritet të kualifikohet për njohje si shitje e përfunduar brenda një viti nga data e klasifikimit

Ato njihen fillimisht me me te voglen e vleres kontabel nese nuk jane klasifikuar me pare sit e mbajtura per shitje dhe vleren e drejte minus koston e shitjes. Aktivet afatgjata te mbajtura per shitje maten ne vijim me me te voglem midis vleres kontabl dhe vleres se drejte minus koston e shitjes. Cdo zhvleresim i ketyre akeiveve njihet nje pasqyren e fitim humbjeve dhe te ardhurave te tjera gjithepershires ne periudhen kur zvleresimi identifikohet.

Kur këto aktive nuk plotësojnë përkufizimin e aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje sepse as shitja nuk pritet të përfundojë brenda një viti nga data e klasifikimit të tyre si aktive afatgjatë që mbahen për shitje ose pronat nuk janë në dispozicion për shitje të menjëhershme në gjendjen e tanishme, këto asetë klasifikohen si inventarë në përputhje me SNK 2 "Inventarët". Aktivet fillimisht njiheshin me vlerën e drejtë kur ishin blerë dhe rregulluar për fshirje në shumën e tyre të rikuperueshme.

(m) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen direkt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktivit të ndërtuar vetë përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte, dhe çdo kosto tjetër direkt të atribuueshme për të sjellë aktivin në kushte pune për përdorimin e paracaktuar, kostot e çmontimit dhe nxjerrjes së pjesëve si dhe restaurimin e vendit në të cilin ato janë vendosur, si dhe kostot e kapitalizuara të huamarrjes. Programi i blerë që është pjesë perbërëse e funksionimit të paisjeve me të cilat ka lidhje kapitalizohet si pjesë e këtyre paisjeve. Kur pjesë të një paisje kanë jetë të dobishme të ndryshme nga paisja, ato do të kontabilizohen si zëra më vete (komponentë kryesorë) të makineri dhe paisjeve. Fitimi ose humbja nga nxjerrja jashtë përdorimi e një aktivit të qëndrueshëm përcaktohet duke krahasuar flukset monetare nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën neto të aktivit, dhe njihen me vlerë neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (vazhdim)

(ii) Kostot e mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese a të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihen në vlerën kontabël të elementit, nëse është e mundur që Banka në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike, që i atribuohen atij elementi, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar ç'rrëgjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi përlogaritet nëpërmjet zvogëlimit të kostos së zërave të aktiveve afatgjata materiale (Toka, Ndërtesa dhe Pajisje) pakësuar kjo me vlerën e tyre të mbetur duke përdorur metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të këtyre aktiveve, zë i cili paraqitet përgjithësisht në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Aktivitetet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit, vetëm në rast se është e sigurt në mënyrë të arsyeshme që Grupi do të përfitojë pronësinë e aktivitetit në përfundim të periudhës së qirasë financiare. Jetëgjatësitë e vlerësuara dhe përdorura për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

• Ndërtesa	20 vjet
• Automjete	5 vjet
• Pajisje zyre	5 vjet
• Kompjuterat dhe pajisje elektronike	4 vjet
• Mobilje dhe pajisje	5 vjet

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia e përdorur dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në çdo fund viti financiar dhe rishikohen sa herë është e nevojshme.

(n) Aktivitetet e qëndrueshme të patrupëzuara

Programet kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluarat nga rënia në vlerë.

Shpenzimet për zhvillimin e programeve kompjuterike njihen si aktive kur Banka është në gjendje të tregojë qëllimin dhe aftësinë për të plotësuar zhvillimin dhe përdorimin e programeve kompjuterike në një mënyrë që të gjenerojë përfitime ekonomike të ardhme, dhe mundet të masë me besueshmëri kostot e përfundimit të zhvillimit. Kapitalizimi i kostove të programeve të zhvilluara nga vetë Banka përfshin të gjithë kostot që i atribuohen direkt zhvillimit të programit kompjuterik dhe amortizohen me jetën e dobishme të tyre. Zhvillimi i programeve kompjuterike shprehet me koston e kapitalizuar duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë.

Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivitetit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është katër vjet. Aktivitetet në proces nuk zhvlerësohen derin në momentin që programi kompjuterik zbatohet. Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo fund viti financiar dhe rregullohen në rastet kur është e nevojshme.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(o) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç pronave të mbajtura për investim dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për renie vlere. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së tij të drejtë, minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë aktualizuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Një humbje nga zhvlerësimi do të njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose NJGJM tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim apo humbje. Një humbje në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi ose të njësisë gjeneruese të parasë (NJGJM) tejkalon vlerën e saj të mbulueshme.

Asetet e korporatës së Bankës nuk gjenerojnë flukse paraje të të ndar dhe nuk përdoren më shumë se një Njësi gjeneruese Monetare. Asetet e korporatës janë alokuar si NJGJM mbi një bazë të arsyeshme dhe të qëndrueshme dhe testohen për zhvlerësim si pjesë e testimit të NJGJM-së, ku janë alokuar asetet e korporatës.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje ose fitim. Si fillim alokohen për të ulur vlerën kontabël neto të çdo emri të mirë të NJGJM-së, dhe më pas për të ulur vlerat kontabël neto të aseteve të tjera në NJGJM me një bazë proporcionale.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me emrin e mirë nuk njihet. Për asetet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi do të rimerret deri në atë masë që vlera kontabël neto e aseteve të mos tejkalojë vlerën kontabël neto që do të përcaktohej, duke i zbritur amortizimin, nëqoftëse nuk është njohur një humbje nga zhvlerësimi.

(p) Provigjionet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provigjionet përcaktohen duke aktualizuar rrjedhat e pritshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Mos pranimit i zbritjes njihet si kosto finance.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka aprovuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Humbjet e ardhshme operative nuk janë të mundura.

(q) Garancitë financiare dhe angazhimet për hua

"Garancitë financiare" janë kontrata të cilat kërkojnë që Banka të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson për shkak se një debitor i caktuar nuk bën pagesat kur duhen, në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. "Angazhimet e kredisë" janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të paracaktuara.

Detyrimet që rrjedhin nga garancitë financiare ose angazhimet për të siguruar një hua me një normë interesi poshtë nivelit të tregut maten fillimisht me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë fillestare amortizohet gjatë jetës së garancisë ose angazhimit. Detyrimi do të kryhet më pas në më të lartën mes vlerës së amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme të shlyerjes së detyrimit kur pagesa sipas kontratës është e mundshme. Garancitë dhe angazhimet financiare për të siguruar një hua me një normë interesi poshtë nivelit të tregut janë të përfshira në detyrimet e tjera.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Përfitimet e punonjësve

i. Plani i kontributeve të përcaktuara

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzime kur shërbimi ofrohet dhe njihet si shpenzimet personeli në fitim ose humbje. Kontributet e parapaguara njihen si aktiv kur një shlyerje në para ose një reduktim në pagesat e ardhshme është i mundshëm.

Detyrimet afat-shkurtra të punonjësve maten në bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin në të cilin kryhet shërbimi. Banka derdh vetëm kontributet e detyruara shoqërore për të siguruar përfitimet e punonjësve pas daljes në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për të siguruar strukturën minimale ligjore për pensionet në Shqipëri nën një plan të caktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Bankës për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e fitim/humbjes në momentin që realizohen. Banka njihet si detyrim shumë e paskontuar të kostos të parashikuara në lidhje me pushimet vjetore që priten të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

(ii) Përfitimet pas largimit nga puna

Përfitimet pas largimit nga puna njihen si shpenzim kur Banka është e angazhuar në mënyrë evidente, pa ndonjë mundësi reale tërheqjeje drejt një plani të detajuar formal për të përfunduar punësimin përpara datës së daljes në pension, ose për të siguruar përfitime largimi nga puna si rezultat i një oferte të bërë për të inkurajuar largime të vullnetshme. Përfitimet nga lënia e punës në rastin kur largimi është i vullnetshëm prej punëmarresit njihen vetëm nëse Banka ka bërë paraprakisht një oferte mbi largimin e vullnetshëm, oferta ka probabilitet të lartë të pranohet, si dhe numri total i pranimeve mund të vlerësohet me përafërsi. Nëse përfitimet paguhet për më shumë se 12 muaj pas periudhës së raportimit, atëherë zhvlerësohen në vlerën e tyre të tashme.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

4. Adaptimi i standarteve të reja dhe atyre të rishikuara

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 "Pasqyra e Levizjes së Parasë"**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime për sa i përket politikave kontabël të Bankës.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi:

SNRF 9 “Instrumentat Financiare” (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Banka parashikon se zbatimi i SNRF 9 në të ardhmen mund të ketë një ndikim në shumat e njohura në aktivet dhe detyrimet financiare. Parashikimi është i bazuar në një kërkesë për të njohur provigjonet në shumën e parashikuar të kredive të pashlyera. Banka do të aplikojë SNRF 9 në 1 Janar 2018, sipas versionit të publikuar në Korrik 2014 dhe do të përshtasë ndryshimet e SNRF 9 në të njëjtën datë

Më 27 dhjetor 2017, Parlamenti Europian publikoi rregulloren (EU) 2017/2395 mbi kërkesat në tranzicion drejt SNRF 9. Rregullorja mundëson zgjedhjen midis dy metodave të ndryshme për sa i përket njohjes së efektit të implementimit të standartit në këto pasqyra financiare:

1. Njohja e efektit të plotë në mënyrë lineare, e shpërndarë në një periudhë 5 vjecare, ose
2. Njohja e impaktit të plotë në ditën e përshtatjes.

Banka ka vendosur të aplikojë metodën e dytë.

Klasifikimi dhe Matja e Përgjithshme

SNRF 9 përmban një përfaqje të re për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare, që reflekton modelin e biznesit sipas të cilit menaxhohen aktivet dhe karakteristikat e fluksit të parasë së tyre.

Banka do të aplikojë katër kategori për klasifikimin e Aktiveve Financiare:

- Aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar (KA)
- Aktivet financiare të matura me vlerë së drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNATGJ)
- Aktivet Financiare të detyrueshme për tu matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes (VDNFH) dhe
- Aktive Financiare të matura me vlerë të drejte nëpërmjet pasqyrave të fitim-humbjes (VDNFH)

Kategoritë ekzistuese të SNK 39 si: të mbajtura deri në maturim, kredi dhe llogari të arkëtueshme, të vlefshme për shitje do të eliminohen.

Aktivët Financiare do të maten me koston e amortizuar nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- Aktiviteti mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbajë aktive financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shprehin qartë termat kohorë të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Objektivi i një modeli biznesi mund të jetë mbajtja e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, edhe në rastin kur shitje të aktiveve financiare kanë ndodhur ose priten që të ndodhin.

Një aktiv financiar klasifikohet si i matur me VDNATGJ nëse ai mbahet nëpërmjet një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbledhë flukse monetare kontraktuale dhe të shesë aktive financiare, kur kushtet kontraktuale të aktiveve financiare specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Për njohjen fillestare të një instrumenti kapitali neto që nuk mbahet për shitje, Banka mund të zgjedhë të paraqesë në mënyrë të pakthyeshme ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Kjo përzgjedhje bëhet për çdo investim individualisht dhe mbulon interesa strategjike që nuk paraqiten plotësisht në mënyrë të konsoliduar. Të gjithë aktivet e tjerë financiare, që nuk plotësojnë kriteret për tu klasifikuar si të matura me koston e amortizuar ose VDNATP, klasifikohen si të matura me vlerën e drejtë, ndryshimet e të cilës njohen në fitim-humbje. Si rrjedhojë, Banka ka mundësinë që në njohjen fillestare të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar, matja e të cilit bëhet me VDNFH, nëse të vepruarit në këtë mënyrë eliminon ose reduktton ndjeshëm një mospërputhje matjeje ose njohjeje, për shembull një mospërputhje kontabël që do të lindte nga matja e aktiveve ose detyrimeve, ose njohja e fitimeve dhe humbjeve në to, në baza të ndryshme. Një aktiv financiar klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen e tij fillestare.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 "Instrumentat Financiare (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka ka vlerësuar objektivin e modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli, dhe kjo reflekton më së miri mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe se si informacioni i përcillet drejtimit. Në vlerësimin se cili model biznesi është i përshtatshëm, janë shqyrtuar kriteret e mëposhtme:

- Si performanca e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të këtij modeli) janë vlerësuar dhe raportuar drejt personelit drejtues të njësisë ekonomike;
- Si ndikojnë rreziqet në performancën e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli) dhe mënyra e menaxhimit të këtyre rreziqeve;
- Si kompensohen drejtuesit e biznesit, p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare ose në flukset monetare kontraktuale të mbledhura;
- Frekuenca, vlera dhe koha e realizimit të shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet dhe pritshmëria për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve; dhe
- Nëse aktiviteti i shitjeve dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale janë pjesë integrale e modelit të biznesit apo ndodhin në mënyrë të rastësishme (modelet mbajtur deri në maturim dhe mbajtur për shitje).

Analizë e Karakteristikave të Flukseve Monetare Kontraktuale

Pasi Banka përcakton se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajtja e aseteve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose njëkohësisht mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare), duhet të vlerësojë nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar specifikojnë datat e caktuara të flukseve monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur. Për këtë qëllim, interesi përcakton vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore. Rreziqe dhe kosto të tjera themelore të huadhënies, si dhe një marzhin e fitimit. Ky vlerësim do të kryhet për çdo instrument në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

Kur vlerëson nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, Banka do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktiviteti financiar përmban një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Banka do të marrë në konsideratë:

- arapagimin, kushtet e zgjatjes së kontratës
- Nëse një kusht i kontratës është i limituar në aktive ose flukse monetare specifike
- Instrumentet e lidhura me kontratë

Modifikimi i vlerës kohore të parasë dhe testit të vlerësimit

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që merr në konsideratë kalimin e kohës (SNRF 9. B4. 1.9A). Nuk merr parasysh rreziqet e tjera (kredisë, likuiditet etj) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një aktiviteti financiar.

Në disa raste, elementi i vlerës në kohë të parasë mund të mos jetë plotësisht i saktë. Një rast i tillë ndodh kur norma e interesit e një aktiviteti financiar rivendoset periodikisht, por frekuenca e kësaj rivendosjeje nuk përputhet me maturitetin e normës së interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin, në mënyrë që të përcaktojnë nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë akoma pagesa vetëm të interesit dhe principalit, që do të thotë maturiteti i rivendosjes nuk ndryshon ndjeshëm flukset e mjeteve monetare nga një instrument standard i përsosur.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 "Instrumentat Financiare (vazhdim)

Vlerësimi i ndikimit në klasifikim dhe matje

SNRF 9 do të ndikojë në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të mbajtura të Bankës më 1 Janar 2018 si më poshtë:

Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët, të klasifikuar si hua dhe llogari të arkëtueshme të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, të matura me koston e amortizuar sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten me koston e amortizuar në përputhje me SNRF 9.

Instrumentet e borxhit të vlefshëm për shitje, të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet kapitalit sipas SNK 39, si rregull gjithashtu do të maten në VDNATGJ në përputhje me SNRF 9.

Kontabiliteti mbrojtës

SNRF 9 lejon opsionet e kontabilitetit mbrojtës. Banka nuk përdor një metodë të tillë kontabiliteti në pasqyrat e saja financiare.

Zhvlerësimi i përgjithshëm

Llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë kërkon përdorimin e parashikimeve kontabël të cilat, sipas përkufizimit, rrallëherë do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Drejtimi ushtron gjykim në zbatimin e politikave kontabël të Grupit.

Banka vlerëson në bazë të parashikimit humbjet e pritura të kredisë të lidhura me aktivet e saj të borxhit të mbartura me koston e amortizuar dhe VDNATGJ, dhe me ekspozimin që rrjedh nga angazhimet e huasë, kontratat e qirasë dhe kontratat e garancisë financiare. Banka njih provigjon për humbje të tilla në çdo datë raportimi.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë

Matja e humbjeve të pritura të kredisë pasqyron një vlerë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, vlerën në kohë të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Matja e lejesës për humbjet e pritshme të kredisë për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është një zonë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimeve të rëndësishme në lidhje me kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e kredisë. Vlerësime të rëndësishme:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritura të kredisë
- Vendosija e numrit dhe peshave relative të skenarëve të ardhshëm për secilin lloj produkti/tregu dhe humbjet e pritura të kredisë të lidhura
- Krijimi i grupeve të aktiveve financiare të ngjashme me qëllim matjen e humbjeve të pritshme të kredisë

Vlerësimi i ekspozimit të kredisë për qëllime të menaxhimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve. Vlerësimi i rrezikut të kredisë për një portofol të aktiveve përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me mundësitë e mosshlyerjeve të ndodhura, të raporteve të lidhura me humbjen dhe korrelacioneve të mosshlyerjeve ndërmjet palëve. Banka mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e mosshlyerjes së kredive, ekspozimin në mosshlyerje të kredisë dhe humbjet nga mosshlyerja. Kjo është një metodë mbizotëruese e përdorur për qëllimet e matjes së humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9.

SNRF 9 përshkruan një model me tre hapa për zhvlerësimin bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Ky model kërkon që një instrument financiar, i cili nuk është i zhvlerësuar nga kreditë në njohjen fillestare, klasifikohet në Fazën 1 dhe rreziku i tij i kreditit monitorohet vazhdimisht. Nëse është identifikuar një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por nuk konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nga kredia. Nëse instrumenti financiar është i zhvlerësuar nga kreditimi, instrumenti financiar më pas zhvendoset në Fazën 3.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 "Instrumentat Financiare (vazhdim)

Për instrumentet financiare në Fazën 1, humbja e pritshme e kredisë matet me një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme gjatë 12 muajve të ardhshëm. Instrumentet në Fazat 2 ose 3 kanë humbjet e pritshme të kredive të matura në bazë të humbjeve të pritura të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë. Sipas SNRF 9, kur matet humbja e pritshme e kredisë është e nevojshme të merret në konsideratë informacioni për të ardhmen.

Rritja e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Banka konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose ndaluese të mëposhtme janë plotësuar:

Kriteret sasiore

Banka përdor kriteret sasiore si tregues parësor të rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale. Për vlerësimin sasiore, Banka krahason kurbën e probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë me të dhënat e matura, me kurbën e ardhshme të probabilitetit të mos pagimit në datën e njohjes fillestare. Për vlerësimin e kurbës së probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë në datën e njohjes fillestare, bëhen supozime rreth strukturës së saj. Për instrumentet financiare me vlerësim të lartë, supozohet se kurba do të përkeqësohet me kalimin e kohës. Për instrumentet financiare me vlerësim të ulët, supozohet se kurba do të përmirësohet me kalimin e kohës. Shkalla e përmirësimit ose përkeqësimit do të varet nga niveli i vlerësimit fillestar.

Kriteret cilësore

Banka përdor kriteret cilësore si një tregues dytësor për rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë për të gjitha portofolet materiale. Transferimi në Fazën 2 zhvillohet kur plotësohen kriteret e mëposhtme.

Për portofolet qeveritare, bankare, të korporatave dhe të financave të projektit, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e jashtëm të tregut
- Ndryshime në kushtet e kontratës
- Ndryshime në qasjen e drejtimit
- Gjykimi i ekspertëve

Për portofolet e tregëtueshme, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Lëshime përsa i përket marrëveshjes së kredisë, kur huamarrësi po kalon vështirësi
- Gjykimi i ekspertëve

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë përfshin informacion për të ardhmen dhe kryhet në baza mujore në një nivel marrëveshjeje për të gjitha portofolet retail të mbajtura nga Banka.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 "Instrumentat Financiare (vazhdim)

Përcaktimi i mospagimit dhe aktiveve të zhvlerësuara nga kreditimi

Banka përcakton që një instrument financiar është në mospagim, i cili është plotësisht i linjësuar me përkufizimin e zhvlerësimit nga kreditimi, kur plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

Përkufizimi i mospagimit bazohet në dy kriteret të përgjithshme, dmth një ekspozim konsiderohet si mospagim gjithmonë kur ose:

1. UTP: Klienti este identifikuar në mospagim për shkak të pamundësisë paguese (identifikuar në dosjen e mospagimit) dhe në të njëjtën kohë ka së paku 1 financim aktiv, ose
 - a. vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose të kredimarrësit;
 - b. një shkelje e kontratës, si një vonesë në pagesat e interesit ose të principalit;
 - c. kreditori, për arsye ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësitë financiare të huamarrësit, duke i dhënë huamarrësit një koncesion që kreditori nuk do ta merrte në konsideratë;
 - d. bëhet e mundur që huamarrësi të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar;
 - e. zhdukja e një tregu aktiv për atë aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare; ose
 - f. të dhënat e vëzhgueshme që tregojnë se ka një ulje të matshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara nga një grup i aktiveve financiare që nga njohja fillestare e këtyre aktiveve, edhe pse rënia nuk mund të identifikohet ende me aktivet individuale financiare në grup, duke përfshirë:
 - i. ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarrësve në grup (p.sh. një numër në rritje pagesash të vonuara); ose
 - ii. kushtet kombëtare ose lokale që lidhen me mospagimin e aseteve në grup (p.sh. rritja e shkallës së papunësisë në zonën gjeografike të huamarrësve, ulja e çmimeve të pronës për hipotekat në zonën përkatëse, ulja e çmimeve të naftës për financim aseteve ndaj prodhuesve të naftës, ose ndryshimeve të pafavorshme në kushtet e industrisë që prekin huamarrësit në grup).
2. 90 DPD: Ekspozimi është më shumë se 90 ditë vonese (DPD90) dhe në të njëjtën kohë është aktive dhe shënohet si në mospagim nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë (ky identifikim është i nevojshëm sepse për disa financime me pagesa / keste jo konsistente, nuk pasqyron saktë kohën e duhur).

Kriteret e mësipërme janë zbatuar mbi të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Banka dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagimit të përdorur për qëllime të menaxhimit të brëndshëm të rrezikut të kredisë.

Shpjegimi i të dhënave, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose jetëgjatësisë, në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet si i dëmtuar nga kredia. Informacioni ekonomik për të ardhmen gjithashtu përfshihet në përcaktimin e probabilitetit të mospagimit 12-mujor dhe të probabilitetit të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktivitetit, ekspozimit në mospagim dhe humbja nga mospagimi. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit. Humbjet e pritshme të kredisë janë prodhimi i probabilitetit të mospagimit, humbja nga mospagimi, ekspozimi në mospagim.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 "Instrumentat Financiare (vazhdim)

Probabiliteti i mosshlyerjes

Probabiliteti i mosshlyerjes paraqet mundësinë që një huamarrës nuk përmbush detyrimet financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur të detyrimit. Si rregull, probabiliteti i mosshlyerjes është llogaritur duke përdorur probabilitetin rregullator 12 mujor të mosshlyerjes, pa asnjë marzh konservatizmi. Më pas përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si do të llogaritet profili i mosshlyerjes nga pika e njohjes fillestare e përgjatë gjithë jetës së kredisë ose portofolit të huave.

Në rastet e kufizuara kur disa të dhëna nuk janë në dispozicion, për llogaritjen përdoret grupimi, mesatarja ose krahasimi i të dhënave.

Humbja nga mosshlyerja

Humbja nga mosshlyerja, paraqet pritshmërinë që ka Banka për shkallën e humbjes lidhur me ekspozim që nuk është paguar në kohë. Kjo humbje varion sipas produktit apo palës së tretë nga e cila rrjedh. Humbja nga mospagimi shprehet si përqindje për njësi ekspozimi në kohën e mospagimit. Ajo llogaritet në bazë 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë, ku humbja nga mospagimi 12-mujor është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse ndodh mospagimi në 12 muajt e ardhshëm dhe humbja nga mospagimi gjatë jetës është përqindja e humbjes që pritet të pësohet nëse mospagimi ndodh gjatë jetës së mbetur.

Ekspozimi i mosshlyerjes

Ekspozimi në mospagim bazohet në shumat që Banka pret që klientët t'i kenë borxh në kohën e mospagimit, gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. Ekspozimi në Mospagim 12-mujor dhe gjatë jetëgjatësisë përcaktohen në bazë të profilit të pagesës së pritshme, e cila ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet e amortizueshme dhe huatë që mundësojnë shlyerjen e njëhershme të principalit në maturim (bullet), llogaritja e ekspozimit në mospagim është bazuar në shlyerjet kontraktuale të huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose për të gjithë jetëgjatësinë.

Informacion për të ardhmen

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritura të kredisë përfshijnë informacion që sheh nga e ardhmja. Banka ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesore ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë për çdo portofol.

Gjykim i ekspertëve zbatohet në këtë proces. Ndikimi i variablave ekonomike mbi probabilitetin e mospagimit, humbja në mospagim dhe ekspozimi në mospagim përcaktohet duke përdorur regresionin statistikor për të kuptuar ndikimin që ndryshimet në këto variabla kanë pasur historikisht në normat e mospagimit dhe mbi përbërësit e humbjes në mospagim dhe ekspozimit në mospagim.

Përveç skenarit ekonomik bazë, modeli gjithashtu ofron një skenar me rastin më të mirë dhe një skenar me rastin më të keq, të ponderuara për të siguruar kapërcimin e jo-linearitetit. Banka ka arritur në konkluzionin se tre skenare ose më pak kapin në mënyrë të përshtatshme jo-linearitetin. Peshat e skenarit përcaktohen nga një kombinim i analizës statistikore dhe gjyqimit të ekspertizës së kredisë, duke marrë parasysh gamën e rezultateve të mundshme që secili skenar i zgjedhur përfaqëson.

Banka konsideron që këto parashikime përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të rezultateve të mundshme dhe mbulojnë çdo jo-linearitet dhe asimetri të mundshme në portofolet e ndryshme të Bankës.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 "Instrumentat Financiare (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në lejesën e humbjes së pritshme së kredisë janë si më poshtë:

- Portofolet e korporatave

PBB-ja tremujore sipas qasjes së prodhimit, rregulluar sipas sezoneve - çmimet aktuale të PBB-së:

- Industria
- Shërbimet e Pasurive të paluajtshme
- Vlera e shtuar bruto ("VSHB")
- Prodhimi I Brendshëm Bruto ("PBB")

PBB-ja tremujore sipas qasjes së shpenzimeve, çmime konstante

- Shpenzimet e Konsumit Final
- Formimi i kapitalit fiks bruto
- Absorbimi vendas
- Eksporti Neto
- Import
- Eksport

- Portofole e tregtueshme Tregu i Punës - Analiza e Fuqisë Punëtore:

- Shkalla e papunësisë
- Pjesëmarrja e fuqisë punëtore

- Çmimet:

- Indeksi i Çmimeve të Konsumit (ICK)
- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (ICP)

Tranzicioni

Ndryshimet në politikat kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në përgjithësi do të zbatohen në mënyrë retrospektive, përveç siç përshkruhet më poshtë:

- Banka do të përfitojë nga përjashtimi duke e lejuar atë të mos rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme në lidhje me ndryshimet në klasifikimin dhe matjen (duke përfshirë zhvlerësim). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9 njihen në fitimet e paspërndara që nga 1 janari 2018.
- Vlerësimet e mëposhtme duhet të bëhen në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar:
 - Përcaktimi i modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv financiar.
 - Emërtimi dhe revokimi i emërtimeve të mëparshme të aktiveve dhe detyrimeve të caktuara financiare të matura në VDNFH
 - Caktimi i disa investimeve strategjike që nuk mbahen për tregtim si në VDNATGJ
- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019),

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

5. Standarde të reja të publikuara por akoma jo efektive (vazhdim)

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat bazuar në Aksione"**, - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"** - Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiarë", është aplikuar për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i asetëve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"**- interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara"** - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),,
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019),
- **KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Banka ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese përpara datës kur hyjnë në fuqi. Me përjashtim të impaktit të SNRF 9, i cili do të vlerësohet nga Banka gjatë vitit 2018, Banka parashikon që adoptimi i standardeve të tjera, ndryshimet dhe interpretimet nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e zbatimit fillestar.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Të përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuditetit
- rreziku i tregut
- rreziqet operacionale.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Bankës për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

Struktura e manaxhimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësinë e plotë për vendosjen dhe kontrollin e strukturës së manaxhimit të riskut të Bankës. Bordi ka përcaktuar njësi të brendshme dhe komitete, të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të manaxhimit të rreziqeve në fushat e tyre specifike.

Janë vendosur politika të manaxhimit të riskut të Bankës për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat përballet Banka, për të vendosur limite të përshtatshme të riskut dhe kontrollit, dhe për të monitoruar risqet dhe përbajtjen ndaj limiteve. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut si dhe produkteve dhe shërbimeve të ofruara. Banka ka për qëllim të ndërtojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit kuptojnë rolin dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit është përgjegjës për monitorimin e përmbushjes së politikave dhe procedurave të Bankës, dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së manaxhimit të riskut në lidhje me risqet me të cilat përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës mbështetet në keto funksione nga Auditimi i Brendshëm. Auditimi i Brendshëm ndërmerr rregullisht dhe ad-hoc rishikime të kontrollit dhe procedurave të manaxhimit të riskut, gjetjet e të cilit raportohen në Komitetin e Auditimit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Bankën në qoftë se një klient ose palë tjetër në një instrument financiar dështon në plotësimin e detyrimeve të tij kontraktuale, dhe lind kryesisht nga aktiviteti financiar i Bankës dhe nga investimet. Për qëllime të manaxhimit të riskut Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit të riskut (sic janë rreziku i individëve në mos përmbushjen e detyrimit, vendndodhja dhe sektori ku operon kredimarrësi).

Administrimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për mbikqyrje të rrezikut të kredisë tek njësi e kredisë. Njësi e Kredisë është përgjegjëse për administrimin e rrezikut të kredisë, duke përfshirë:

- Formulimin e politikave të kredisë, kërkesat e mbulimit të kolateralit, vlerësimin e kredisë, gradat e riskut dhe raportimi, procedurat e dokumentimit të ligjore, dhe përmbushjen e kërkesave rregullatore dhe ligjore.
- Vendosjen e strukturës së autorizimit për aprovimin dhe rinovimin e kushteve të kredisë.
- Rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë përpara se ato t'i paraqiten klientit. Rinovimet dhe rishikimet janë subjekt i të njëjtit proces.
- Kufizimin e përqëndrimeve të ekspozimit për palet e tjera, gjeografikisht dhe industritë.
- Zhvillimin dhe mbajtjen e gradës së riskut për të kategorizuar ekspozimet në përputhje me masën e riskut të humbjes financiare të përballur dhe për të fokusuar manaxhimin me risqet potenciale. Sistemi i gradës së riskut përdoret në përcaktimin se kur mund të kërkohet provizion për zhvlerësimin ndaj ekspozimeve specifike të kredisë.

Komiteti i Kredisë së Bankës aprovon kërkesa për kredi deri në shumën 60,000 mijë Lekë, ndërsa kërkesat për kredi për më shumë se 60,000 mijë Lekë aprovohen nga Bordi i Drejtuesve të Bankës

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Ekspozimet maksimale të kredisë përpara kolateralit si dhe ndryshimeve të tjera nga rreziku i kredisë në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	Shkalla	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Vlera kontabël e mbajtur me koston e amortizuar				
Paraja dhe ekuivalentët e saj	A	9	3,517,936	2,965,941
Teprica të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	A	10	530,747	486,424
Investimet me bankat dhe institucionet financiare	A	11	-	234,253
Mudaraba – fonde investimi	E	12	50,321	77,404
Bono Thesari të mbajtura deri në maturim	A	13	-	-
	Shikoni më			
Murabaha – aktivitete financuese	poshtë	14	4,010,307	3,325,689
Pjesa e papërdorur e anagzhimeve financiare			41,006	1,040
Garanci të dhëna klientëve	A	29	20,507	26,051
Totali			8,170,824	7,116,802

Zhvlërësimi i aktiveve financiare të arkëtueshme dhe investimeve

Te arkëtueshmet financiare dhe investimet individualisht të zhvlerësuara janë huatë dhe investimet për të cilat Banka përcakton që ka një evidencë objektive për rënie në vlerë dhe ajo nuk pret të mbledhë të gjithë principalin dhe interesin e detyruar në përputhje me termat kontraktuale. Këto aktive financiare janë vlerësuar me A deri në E në sistemin e brendshëm të vlerësimit të rrezikut të kredisë së Bankës.

Hua dhe investime me vonesë por jo të zhvlerësuara

Hua dhe investime me vonesë por jo të zhvlerësuara, përveç atyre që mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë ato për të cilat të ardhurat kontraktuale ose pagesat e principalit e kanë kaluar datën, por për të cilat Banka beson se rënia në vlerë nuk është e përshtatshme bazuar në nivelin e sigurisë/ të kolateralit të disponueshëm dhe/ose pritshmëritë për mbledhjen e shumave që u detyrohen Bankës.

Fondi për zhvlërësim

Banka krijon një fond për humbjet nga zhvlërësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar ose të klasifikuara si të vlefshme për shitje që përfaqësojnë një parashikim të saj për humbjet në portofol. Përbërësit kryesorë të këtij fondi janë pjesa e humbjeve që lidhen me ekspozimet domethënëse individuale, dhe pjesa e humbjeve e vlerësuar në mënyrë kolektive për grupet e aktiveve homogjene dhe që ka të bëjë me humbjet që kanë ndodhur por që nuk janë identifikuar mbi aktivet financiare që janë konsideruar individualisht jodomethënëse, si dhe me ekspozimet individualisht domethënëse që janë subjekt i vlerësimeve individuale për zhvlërësim por që nuk janë gjetur të jenë individualisht të zhvlerësuara.

Aktivet financiare të arkëtueshme me terma të rinegociuara

Aktivet financiare të arkëtueshme me terma të rinegociuara janë aktivet që janë ristrukturuar si pasojë e përkeqësimit të pozicionit financiar të huamarrësit dhe për të cilat Banka ka bërë leshime të cilat nuk do t'i konsideronte në rrethana të tjera.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Politikat e fshirjes

Banka fshin balancën e një aktivi dhe cdo fondi tjetër për humbjet nga zhvlerësimi të lidhur me të, kur departamenti i kredisë përcakton që aktivi nuk do të arkëtohet më. Ky përcaktim bëhet pasi merren në konsiderat informacione të rëndësishme, të tilla si ndryshimi domethënës i pozicionit financiar të huamarrësit / emetuesit, sipas të cilave huamarrësi / emetuesi nuk mund të paguajë me detyrimin, apo që flukset nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Për huatë me balancë më të vogël të standardizuar, vendimet e përgjithshme për fshirje janë bazuar në statusin e vonesës të produktit specifik.

Gjatë vitit 2017 Banka ka fshirë disa të arkëtueshme financiare të cilat kanë qenë në ekzekutim për disa vite dhe nuk është gjetur ndonjë burim për t'i rikuperuar. Shuma e kredive të fshira është 26,268 mijë Lek (2016: 5,656 mijë Lek).

Tabela e mëposhtme tregon një analizë të zhvlerësimit të aktiveve financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Murabaha – aktivitete financuese

		31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Me kosto të amortizuar			
<i>Zhvlerësim individual: Grada B-E</i>		809,000	661,419
<i>Zhvlerësimi kolektiv: Grada A (risk i ulët - risk i drejtë)</i>		3,432,260	2,940,448
Shuma bruto	11	4,241,260	3,601,867
Totali i fondit për zhvlerësim	11	(230,953)	(276,178)
Vlera kontabël		4,010,307	3,325,689

Në 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Banka ka angazhimet e patërhequra të kredisë si vijon:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pjesa e papërdorur e financimit	41,005	1,040

Banka mban kolaterale kundrejt aktiveve financiare në formën e hipotekës mbi pronën, aktive të tjera të regjistruara si kolateral dhe garanci. Vlerësimet e vlerës së drejtë janë të bazuara në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huadhënies, dhe përgjithësisht nuk janë të përditësuara përveçse kur një aktiv është individualisht i zhvlerësuar. Një vlerësimi i vlerës së drejtë të kolateralit kundrejt huave në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 tregohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Prona të patundshme	24,422,524	11,540,918
Makineri, pajisje dhe inventar	738,907	360,593
Mjete monetare të bllokuara	73,721	221,826
Të tjera	154,997	957
Totali	25,390,149	12,124,294

Në përgjithësi, nuk mbahet kolateral mbi tepricat me bankat dhe institucionet financiare dhe nuk ka kolateral të tillë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)
 (b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Detaje të aktiveve të marra nga Banka duke marrë në zotërim kolateralin e mbajtur për sigurim kundrejt të arkëtueshmeve financiare, janë treguar në Shënimin 12. Politika e Bankës është realizimi i shitjes së kolateralit. Banka në përgjithësi nuk e përdor kolateralin jo-monetar për aktivitetet e veta.

Detajet e Fondit të investimit - Mudaraba të mbajtur nga Banka me 31 dhjetor 2017 e 2016, janë të prezantuara në shënimin 9.

Banka monitoron përqendrimet e rrezikut të kredisë sipas sektorit dhe vendndodhjes gjeografike. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kredisë nga Paraja dhe ekuivalentët e saj, investimet me bankat dhe institucionet financiare dhe tepricat e kushtezuara me Bankën e Shqipërisë (së bashku paraqiten si Paraja dhe ekuivalentët e saj) dhe nga Murabaha-të arkëtueshme financiare dhe Bono Thesari të mbajtura deri në maturim (Bono thesari) në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

	Paraja dhe ekuivalentët e saj		Murabaha – të akëtueshme financiare		% mbi total
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	
Vlera kontabël	4,048,683	3,686,618	4,010,307	3,325,689	
Të përqendruara sipas sektorit					
Korporata	-	-	2,781,763	2,551,948	77%
Qeveri	443,349	519,312	-	-	0%
Institucione financiare	3,605,334	3,167,306	247,641	67,289	2%
Për individët	-	-	980,903	706,452	21%
Totali	4,048,683	3,686,618	4,010,307	3,325,689	
% e përqendrimit për cdo zë	50%	53%	50%	47%	

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

	Paraja dhe ekuivalentët e saj		Murabaha – te arktueshme financiare	
	31 dhjetor 2017	% mbi total	31 dhjetor 2016	% mbi total
Vlera kontabël	4,048,683		3,686,618	
Përqëndrimi sipas vendndodhjes				
Shqipëri	1,433,433	35%	1,453,901	39%
Europë	241,915	6%	76,305	2%
Azi	2,350,962	58%	1,802,673	49%
Lindje e Mesme e Afrikë	22,373	1%	353,739	10%
Totali	4,048,683	100%	3,686,618	100%
% e përqëndrimit për çdo zë	50%		53%	
Përqëndrimet sipas vendndodhjes për llogaritë me bankat dhe institucionet e tjera financiare maten bazuar në vendndodhjen e njësisë së Bankës që mban aktivin, që ka një lidhje të lartë me vendndodhjen e huamarrësit. Përqëndrimi i vendndodhjes për letrat me vlerë matet bazuar në vendndodhjen e emetuesit të letrës me vlerë. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me bankën qëndrore që ka gradën B+ (2016:B+) dhe bankat dhe institucionet financiare bazuar në klasifikimet e kompanisë Standard & Poor's që janë si me poshte vijon:				
	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
Klasifikimi A deri BBB+	359		538	
Klasifikimi BBB deri B-	3,039,201		3,361,200	
Pa klasifikim	612,518		363	
	3,652,078		3,362,101	
Arka (shenimi 9)	396,605		324,517	
Totali	4,048,683		3,686,618	

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

- 6 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**
(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit të të arkëtueshmeve financiare janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Teprica në fillim të vitit	276,178	332,967
Zhvlerësime gjatë vitit	162,280	116,416
Rimarrje gjatë vitit	(181,424)	(167,528)
Fshirje e te arkëtueshmeve financiare	(26,081)	(5,677)
Teprica në fund të vitit	230,953	276,178

Norma e fitimit për financimet varion nga 2.5% në 13.53% në vit për valutë dhe nga 2.26% në vit në Lek (31 Dhjetor 2016: nga 2.5% në 13.03% në vit në valutë dhe nga 2.5% në 17% në vit në Lek).

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Të arkëtueshmet financiare të detajuara sipas segmenteve të biznesit më 31 dhjetorit 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

31 dhjetor 2017

	Individe	Korporate	SME	Person fizik	Staffi	Totali
Linje kredie	2,384	-	-	-	-	2,384
Financime						
Afatshkurter	7,375	241,322	1,007,014	59,437	792	1,315,940
Afatmesëm	131,647	61,721	793,870	67,246	14,808	1,069,292
Afatgjatë	829,723	209,602	637,428	173,662	38,589	1,889,004
Minus tarifen e aplikimit	(15,929)	(3,791)	(18,078)	(4,166)	(11)	(41,975)
	955,200	508,854	2,420,234	296,179	54,178	4,234,645
Te tjera	5,503	-	-	1,112	0	6,615
Totali	960,703	508,854	2,420,234	297,291	54,178	4,241,260

31 dhjetor 2016

	Individe	Korporate	SME	Person fizik	Staffi	Totali
Linje kredie	1,466	-	-	-	-	1,466
Financime						
Afatshkurter	4,440	401,949	736,387	29,251	862	1,172,889
Afatmesëm	100,747	106,053	804,769	40,000	12,083	1,063,652
Afatgjatë	612,473	(3,843)	633,712	124,743	13,325	1,384,253
Minus tarifen e aplikimit	(10,995)		(14,615)	(3,018)		(32,471)
	706,665	504,159	2,160,253	190,976	26,270	3,588,323
Te tjera	10,465		501	1,112		12,078
Totali	718,596	504,159	2,160,754	192,088	26,270	3,601,867

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit për financimet e arketueshme të detajuara sipas segmenteve të biznesit për 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

	31 dhjetor 2017				Totali
	Individe	Korporate	SME	Person fizik	
Teprica në fillim të vitit	37,866	-	216,759	21,062	276,178
Zhvlërësime gjatë vitit	39,545	-	90,871	31,526	162,280
Rimarrje gjatë vitit	(34,439)	-	(100,214)	(46,001)	(181,424)
Fshirje e te arketueshmeve financiare	(8,012)	-	(18,069)	-	(26,081)
Teprica në fund të vitit	34,960	-	189,347	6,587	230,953

	31 dhjetor 2016				Totali
	Individe	Korporate	SME	Person fizik	
Teprica në fillim të vitit	29,474	337	288,696	13,531	332,966
Zhvlërësime gjatë vitit	28,333	-	44,152	43,731	116,416
Rimarrje gjatë vitit	(19,883)	(337)	(110,470)	(36,200)	(167,527)
Fshirje e te arketueshmeve financiare	(58)	-	(5,619)	-	(5,677)
Teprica në fund të vitit	37,866	-	216,759	21,062	276,178

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përqendrimi i rrezikut sipas sektorëve ekonomikë brenda portofolit të borxhit nga financimet janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shuma	%	Shuma	%
Ne miqe Lek				
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake	1,502,615	35.43%	1,399,571	38.86%
Tregti me pakicë	1,145,430	27.01%	775,649	21.53%
Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	-	0.00%	-	0.00%
Industria përpunuese	455,938	10.75%	311,281	8.64%
Ndërtimi	516,212	12.17%	694,288	19.28%
Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	254,309	6.00%	73,329	2.04%
Transporti, Magazinimi dhe Telekomunikacioni	40,997	0.97%	37,746	1.05%
Agrikultura dhe gjuetia	10,988	0.26%	31,691	0.88%
Kolektive, sociale dhe personale	41,909	0.99%	55,308	1.54%
Shëndetësi dhe punë sociale	22,598	0.53%	31,804	0.88%
Edukimi	32,588	0.77%	35,752	0.99%
Hotele dhe restorante	109,417	2.58%	86,247	2.39%
Te tjera	108,259	2.55%	69,201	1.92%
Totali i financimeve te arketueshme (perpara zhvleresimit)	4,241,260	100%	3,601,867	100%

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Efektet financiar i kolateralit është duke u shpërndarë duke ndarë vlerën e kolateralit veçmas

- (i) ato aktive ku vlera e kolateralit është e barabartë ose e tejkaluar vlera kontabël e aktiveve (aktivet e mbi kolateralizuara)
- (ii) dhe (ii) ato aktive ku vlera e kolateralit është më e vogël se vlera kontabël e aktiveve (aktivet e nën kolateralizuara).

Vlera e kolateralit për 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

2017	Aktive të mbi- kolateralizuara		Aktive të nën- kolateralizuara	
	Vlera e mbartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e mbartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit
Korporate	506,294	1,516,185	-	-
SME	2,386,093	18,577,861	29,402	6,700
Person Fizik	290,398	1,287,402	4,333	2,657
Individ	995,678	4,061,907	14,087	6,257

Vlera e kolateralit për 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

2016	Aktive të mbi- kolateralizuara		Aktive të nën- kolateralizuara	
	Vlera e mbartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e mbartur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit
Korporate	503,062	1,373,794	-	-
SME	2,011,117	13,796,912	154,022	-
Person Fizik	184,865	814,857	6,126	431,400
Individ	658,416	3,413,238	84,260	17,003,531

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka mund të ndeshë vështirësi në përballimin e detyrimeve të saj financiare, që shlyhen me para ose aktive të tjera financiare.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i Bankës për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit është të sigurohet, sa më shumë që të jetë e mundur, që do të ketë përherë likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme ose pa rrezikuar çënimin e emrit të saj.

Thesari merr informacion nga njësitë e tjera në lidhje me profilin e likuiditetit të aktiveve dhe pasiveve të tjera financiare dhe detajet e flukseve të ardhshme të parave që rezultojnë nga aktivitetet e ardhshme. Thesari mban teprica të një portofoli me aktive afatshkurtra likuide, të përbërë kryesisht nga bonot e thesarit likuide afatshkurtra dhe vendosje me bankat dhe institucione të tjera financiare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm të likuiditetit të Bankës.

Thesari monitoron në baza ditore përputhshmërinë me rregulloret dhe limitet rregullatore të vendosura nga banka e Shqipërisë. Të gjithë politikat dhe procedurat e likuiditetit janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga Komiteti i Aktiveve dhe Pasiveve të Bankës ('ALCO').

Banka mbështetet në depozitat nga klientët dhe bankat, dhe kontributet nga aksionarët e saj si burimi primar i sigurimit të fondeve. Ndërkohë që kontributet nga aksionarët nuk kanë një maturitet të caktuar, depozitat nga klientët dhe bankat përgjithësisht kanë maturitet të shkurter dhe një pjesë e madhe e tyre janë të ripagueshme sipas kërkesës. Natyra afat-shkurtër e këtyre depozitave rrit rrezikun e likuiditetit të Bankës, dhe Banka aktivisht manaxhon këtë rrezik nëpërmjet mbajtjes së cmimit konkurrues dhe monitorimit konstant të tendencave të tregut.

Më 31 dhjetor 2017, njëzetë tepricat më të mëdha të klientëve përfaqësojnë 30% të totalit (2016: 26%).

Tabela e mëposhtme tregon aktivet dhe detyrimet financiare të Bankes sipas maturitetit të mbetur në 31 dhjetor 2017 and 2016:

2017	Pa afat	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët							
Arka dhe llogaritë me bankat*	530,525	3,151,353	366,805	-	-	-	4,048,683
Murabaha – të arkëueshme financiare	-	411,794	213,852	406,796	778,354	2,199,511	4,010,307
Bono Thesari – te mbajtura ne maturim	-	-	-	-	-	-	-
Mudaraba – fonde investimi	-	-	-	-	-	50,321	50,321
Totali	530,525	3,563,147	580,657	406,796	778,354	2,249,832	8,109,311
Detyrimet							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	560,025	132,950	-	-	-	692,975
Hua nga institucione financiare	-	217,484	-	-	-	-	217,484
Detyrime ndaj klientëve	-	2,755,759	600,530	650,360	1,617,263	647,029	6,270,941
Totali	-	3,533,268	733,480	650,360	1,617,263	647,029	7,181,400
Pozicioni neto i likuiditetit	530,525	29,879	(152,823)	(243,564)	(838,909)	1,602,803	927,911
Pozicioni neto i likuiditetit i akumuluar	530,525	560,404	407,581	164,017	(674,892)	927,911	

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat ne '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

2016	Pa afat	Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
Aktivët							
Arka dhe llogaritë me bankat*	486,424	1,333,070	1,632,870	-	-	234,254	3,686,618
Murabaha – të arkëueshme financiare	-	416,305	277,408	209,589	867,560	1,554,827	3,325,689
Bono Thesari – te mbajtura ne maturim	-	-	-	-	-	-	-
Mudaraba – fonde investimi	-	-	-	-	-	77,404	77,404
Totali	486,424	1,749,375	1,910,278	209,589	867,560	1,866,485	7,089,711
Detyrimet							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	495,478	-	-	92,993	35,590	624,061
Hua nga institucione financiare	-	135,249	-	-	35,583	-	170,832
Detyrime ndaj klientëve	-	2,363,011	513,854	520,840	1,340,903	437,571	5,176,179
Totali	-	2,993,738	513,854	520,840	1,469,479	473,161	5,971,072
Pozicioni neto i likuiditetit	486,424	(1,244,363)	1,396,424	(311,251)	(601,919)	1,393,324	1,118,639
Pozicioni neto i likuiditetit i akumuluar	486,424	(757,939)	638,485	327,234	(274,685)	1,118,639	

*Arka dhe mjete monetare te ngjashme, investimet me bankat dhe institucionet financiare, llogaritë e kushtezuara me Banken Qëndrore janë paraqitur se bashku me 'Arka dhe llogaritë me bankat'.

Tabela e mëparshme paraqet rrjedhjet e skontuara të parasë prej instrumentave financiare të Bankës, mbi bazën e maturitetit kontraktual më të shpejtë të mundshëm. Rrjedhja e parasë, e pritshme prej Bankës, lidhur me këto instrumente ndryshon në mënyre domethënëse nga kjo analizë. Për shembull, llogaritë rrjedhëse të klientëve, pritet të mbajnë një gjendje të qëndrueshme ose rritëse. Tabela e mëposhtme paraqet detyrimet financiare të paskontuara sipas maturitetit të mbetur kontraktual, duke përfshirë angazhimet dhe garancite financiare të dhëna.

31 dhjetor 2017	Fluksi dalës bruto					
	Vlera Kontabël	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri në 1 vit	Mbi 1 vit
Detyrimet						
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve financiare	692,975	560,096	132,967	-	-	-
Hua nga institucione financiare	217,484	217,553	-	-	-	-
Detyrime ndaj klienteve	6,270,941	2,773,673	604,434	654,588	1,627,776	651,235
Angazhime dhe garanci financiare	20,507	20,507	-	-	-	-
Totali	7,201,907	3,571,829	737,401	654,588	1,627,776	651,235
<hr/>						
31 dhjetor 2016	Fluksi dalës bruto					
Detyrimet	Vlera Kontabel	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri në 1 vit	Mbi 1 vit
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve financiare	624,061	496,172	-	-	93,123	35,640
Hua nga institucione financiare	170,832	135,566	-	-	35,666	-
Detyrime ndaj klienteve	5,176,179	2,379,405	517,419	524,453	1,350,206	440,607
Angazhime dhe garanci financiare	27,091	2,568	-	3,381	21,142	-
Totali	5,998,163	3,013,711	517,419	527,834	1,500,137	476,247

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat ne '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Për të manaxhuar rrezikun e likuiditetit që lind nga detyrimet financiare, Banka mban aktive likuide që përfshijnë arkën dhe mjete monetare të ngjashme dhe investimet për të cilat ka një treg aktiv likuid. Këto aktive mund të përdoren menjëherë për të përmbushur kërkesat e likuiditetit.

(d) Rreziqet e tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në cmimet e tregut, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, do të prekin të ardhurat e Bankës ose vlerën e instrumentave të saj financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut, është të manaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut, brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin ndaj riskut.

Ekspozimet ndaj riskut të normave të tregut

Risku kryesor, për të cilin portofolet jo-tregtare janë të ekspozuara është rreziku i humbjes nga ndryshimet në rrjedhjen e parasë ose vlerat e drejta të instrumentave financiare për shkak të ndryshimit të normat e interesit. Banka tenton të zbusë riskun duke monitoruar datat e ricimit të aktiveve dhe pasiveve të saj. Gjithashtu, efekti aktual do të varet nga një numër i caktuar faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën ripagesat bëhen më herët ose më vonë se data kontraktuale dhe variacionet në ndjeshmëri brenda periudhave të ricimit dhe ndërmjet monedhave.

Analiza e ricimit të normave të interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e ricimit të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës. Aktivitet dhe detyrimet me normë të ndryshueshme janë raportuar në përputhje me datën e tyre të ardhshme të ndryshimit të normave të interesit. Aktivitet dhe pasivet me normë fikse janë raportuar në përputhje me datën e ripagesës së skedulit të principalit.

2017	Deri ne 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit	Nuk sjellin interes	Totali
Aktive							
Arka dhe llogarite me bankat	2,418,023	366,805	-	-	-	1,263,855	4,048,683
Murabaha – te arketueshme financiare	411,794	213,852	406,796	778,354	2,199,511	-	4,010,307
Bono Thesari – mbajtur ne maturim	-	-	-	-	-	-	-
Mudaraba – fonde investimi	-	-	-	-	-	50,321	50,321
Totali	2,829,817	580,657	406,796	778,354	2,199,511	1,314,176	8,109,311
Detyrimet							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	560,025	132,950	-	-	-	692,975
Hua nga institucione financiare	-	217,484	-	-	-	-	217,484
Detyrime ndaj klientëve	887,155	600,530	650,360	1,617,263	647,029	1,868,604	6,270,941
Totali	1,664,664	733,480	650,360	1,617,263	647,029	1,868,604	7,181,400
Pozicioni neto	1,165,153	(152,823)	(243,564)	(838,909)	1,552,482	(554,428)	927,911
Pozicioni neto i akumuluar	1,165,153	1,012,330	768,766	(70,143)	1,482,339	927,911	

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat ne '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

2016	Deri ne 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit	Nuk sjellin interes	Totali
Aktive							
Arka dhe llogarite me bankat	1,086,486	1,632,871	-	-	234,253	733,008	3,686,618
Murabaha – te arketueshme financiare	382,458	291,657	597,383	1,775,405	278,786		3,325,689
Bono Thesari – mbajtur ne maturim	-	-	-	-	-	-	-
Mudaraba – fonde investimi	-	-	-	-	-	77,404	77,404
Totali	1,468,944	1,924,528	597,383	1,775,405	513,039	810,412	7,089,711
Detyrimet							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	495,478	-	-	92,993	35,590	624,061
Hua nga institucione financiare	-	135,249	-	-	35,583	-	170,832
Detyrime ndaj klientëve	1,039,657	513,854	520,840	1,340,903	434,317	1,326,558	5,176,129
Totali	1,667,561	513,854	520,840	1,469,479	469,934	1,329,404	5,971,072
Pozicioni neto	(198,617)	1,410,674	76,543	305,926	43,105	(518,992)	1,118,639
Pozicioni neto i akumuluar	(198,617)	1,212,057	1,288,600	1,594,526	1,637,631	1,118,639	

Administrimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt limiteve, plotësohet edhe nga monitorimi i ndjeshmësisë së aktiveve dhe pasiveve financiare të Bankës, me skenarë të ndryshëm të normave të kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës për një rritje ose zbritje në normat e interesit, duke supozuar që nuk ka një lëvizje asimetrike në kurbat e normave të interesit dhe një pozicion financiar konstant, është si më poshtë:

2017	Skenarët deri në një vit		Skenarët mbi një vit	
	100 pikë Rënie	100 pikë Rritje	100 pikë Rritje	100 pikë Rënie
Efekti i Fitimit (humbjes) së vlerësuar	(851)	851	14,902	(14,902)
2016	Skenaret deri në një vit		Skenarët mbi një vit	
	100 pikë Rritje	100 pikë Rënie	100 pikë Rritje	100 pikë Rënie
Efekti i Fitimit (humbjes) së vlerësuar	9,945	(9,945)	431	(431)

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku tregut (vazhdim)

Lëvizjet e normave të interesit prekin fitimet e mbajtura që lindin nga rritjet ose zbritjet në të ardhurat neto nga operacionet bankare dhe ndryshimet në vlerat e drejta të raportuara në fitim ose humbje.

Ekivalentet e mesatares së ponderuar të normave të tregut për aktivet dhe pasivet financiare kryesore janë si më poshtë:

	Mesatarja e ponderuar e normave të interesit					
	(Lek)		(USD)		(EUR)	
	2017	2016	2017	2016	2017	2016
<i>31 dhjetor</i>						
Aktive						
Bankat dhe institucionet financiare	1.28%	1.25%	2.14%	1.79%	0.92%	0.94%
Të arkëtueshme financiare	6.52%	8.71%	5.08%	6.51%	5.36%	7.38%
Bono Thesari	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	0.00%	0.00%	0.80%	0.67%	0.10%	0.23%
Detyrime ndaj klientëve	1.72%	1.76%	0.65%	0.69%	0.59%	0.77%

Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e kurseve të këmbimit. Banka tenton të administrojë këtë rrezik duke mbyllur pozicionet e hapura ditore në monedhë të huaj dhe duke monitoruar limitet e pozicioneve të hapura.

Tabela e mëposhtme përmbledh pozicionin neto të aktiveve dhe pasiveve në monedhë të huaj të Bankës, më 31 dhjetor 2017 and 2016 prezantuar në mijë Lekë dhe një analizë e ndjeshmërisë së fitimit të bankës si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit të Lekut në raport me monedhat kryesore për të cilat Banka ka ekspozime.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat ne '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

31 dhjetor 2017	LEK	USD	EURO	Tjetër	Totali
Aktivët					
Arka dhe llogaritë me bankat	757,743	1,571,704	1,689,829	29,407	4,048,683
Murabaha – te arketueshme financiare	1,713,561	641,238	1,655,508	-	4,010,307
Bono Thesari – deri ne maturim	-	-	-	-	0
Mudaraba –fonde investimi	-	50,321	-	-	50,321
Totali	2,471,304	2,263,263	3,345,337	29,407	8,109,311
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	92,127	600,848	-	692,975
Hua nga institucione financiare	-	111,122	106,362	-	217,484
Detyrime ndaj klientëve	2,924,625	711,414	2,599,592	35,310	6,270,941
Totali	2,924,625	914,663	3,306,802	35,310	7,181,400
Pozicioni neto	(453,321)	1,348,600	38,535	(5,903)	927,911
Pozicioni neto i Akumuluar	(453,321)	895,279	933,814	927,911	
Analiza e ndjeshmerise					
Zhvlerësimi i Lek-ut me 10%		134,860	3,853	(590)	
Zhvlerësimi i Lek-ut me 5%		67,430	1,927	(295)	
Zhvlerësimi i Lek-ut me 10%		(134,860)	(3,853)	590	
Zhvlerësimi i Lek-ut me 5%		(67,430)	(1,927)	295	
31 dhjetor 2016					
Aktivët					
Arka dhe llogarite me bankat	911,347	1,617,042	1,123,729	34,500	3,686,618
Murabaha – te arketueshme financiare	1,302,685	658,866	1,364,138	-	3,325,689
Bono Thesari –deri ne maturim	-	-	-	-	-
Mudaraba – fond investimi	-	77,404	-	-	77,404
Totali	2,214,032	2,353,312	2,487,867	34,500	7,089,711
Pasivet					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	712	283,186	340,163	-	624,061
Hua nga institucione financiare	-	35,602	135,230	-	170,832
Detyrime ndaj klientëve	2,646,277	518,545	1,976,359	34,998	5,176,130
Totali	2,646,989	837,333	2,451,752	34,998	5,971,072
Pozicioni neto	(432,957)	1,515,979	36,115	(498)	1,118,639
Pozicioni neto i Akumuluar	(432,957)	1,083,022	1,119,137	1,118,639	
Analiza e ndjeshmerise					
Zhvlerësimi i Lek-ut me 10%		151,598	3,614	(50)	
Zhvlerësimi i Lek-ut me 5%		75,799	1,807	(25)	
Zhvlerësimi i Lek-ut me 10%		(151,598)	(3,614)	50	
Zhvlerësimi i Lek-ut me 5%		(75,799)	(1,807)	25	

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Rreziku operacionale

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte ose indirekte që lindin nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e Bankës, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën, dhe nga faktorë të jashtëm të ndryshëm nga rreziku i kredisë, i tregut dhe i likuiditetit, dhe që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore, dhe standarte përgjithësisht të pranuar të sjelljes operative. Rreziqet operacionale lindin nga të gjitha operacionet e Bankës.

Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional, në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës, me kostot efektive dhe të shmangë procedurat e kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Zbatimi i kontrolleve për adresuar rrezikun operacional është mbështetur nga zhvillimi i një sërë standartesh për administrimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- përputhja me kërkesat ligjore dhe rregullatore
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- kërkesat për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale të hasura, dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuar
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe veprimet rregulluese të propozuara
- zhvillimi i planeve të mundshme
- trainimi dhe zhvillimi profesional
- standartet etike dhe të biznesit
- zvogëlimi i rrezikut, duke përfshirë sigurimin në rastet kur ky është efektiv.

Përputhshmëria me standardet e brendshme mbështetet nga një program rishikimesh periodike të ndërmarra nga Auditi i Brendshëm. Rezultatet e rishikimeve të bëra nga Auditi i Brendshëm diskutohen me manaxhimin e njësisë së biznesit me të cilin ato lidhen, me përmbledhjet e dorëzuara në Komitetin e Auditit dhe manaxhimi i lartë i Bankës.

(iv) Administrimi i kapitalit

Kapitali rregullator

Banka e monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj, vec të tjerash edhe duke përdorur rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori shqiptar, Banka e Shqipërisë ("BSH") e cila përcakton kapitalin rregullator të kërkuar për të mbështetur biznesin e Bankës. Rregullroja "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit" është nxjerre, në përputhje me Ligjin për Bankat. Kapitali rregullator më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fondi total aksioner*	1,249,557	1,442,613
Aktive të paprekshme të zbritshme*	(3,286)	(3,064)
Pjesa e zbritshme e aktiveve afatgjata *	-	-
Kapitali rregullator (shiko shënimin 1(b))*	1,246,271	1,439,549

*Shumat në tabelë përfaqësojnë tepëricat bazuar në kërkesat e Bankës së Shqipërisë, të cilat ndryshojnë nga ato të raportuara në përputhje me SNRF-të. Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë nuk janë finalizuar në kohën e plotësimit të këtyre pasqyrave financiare. Sidoqoftë, Manaxhimi beson që aftësia e Bankës për të vazhduar aktivitetin nuk do të përkeqësohet.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me aktivet e ponderuara me rrezikun dhe zërat jashtë bilancit, i shprehur si përqindje. Raporti minimal i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, kërkuar nga Banka e Shqipërisë është 12%

Raporti i modifikuar i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit bazë me aktivet dhe zërat jashtë bilancit, të shprehura në përqindje. Norma minimale e modifikuar e mjaftueshmërisë së kapitalit është 6%.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat ne '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Administrimi i kapitalit (vazhdim)

Banka i ka përmbushur Raportet e Mjaftueshmërisë së Kapitalit gjatë periudhës. Ne datën 31 Dhjetor 2016 Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 21.19 % (ne 2016 : 28.3 %).

Aktivet e Ponderuara me Rrezikun (APR)

Aktivet ponderohen me rrezikun në përputhje me kategoritë e gjera të riskut, të cilave u caktohet një peshë rreziku në përputhje me shumat e kapitalit, të nevojshme për t'i mbështetur ato. Aplikohen katër kategori të ponderimit të rrezikut (0%, 20%, 50%, 100%); për shembull paraja dhe instrumentet e tregut të parase me Bankën e Shqipërisë kanë ponderim zero, që do të thotë se nuk duhet kapital për të mbështetur mbajtjen e këtyre aktiveve. Ndërsa mjetet e qendrueshme ponderohen me 100%, që do të thotë se duhet të mbështeten me një kapital të barabartë me 12% të vlerës së tyre kontabël.

Llogaritë që lidhen me angazhimet për kredi, gjithashtu merren në konsideratë dhe ponderohen duke përdorur të njëjtat norma përqindjesh si për aktivet.

7. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Manaxhimi diskuton me Komitetin e Auditimit zhvillimin, përzgjedhjen dhe shënimet për politikën dhe vlerësimeve kontabël kryesore të Bankës, dhe zbatimin e këtyre të politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime plotësojnë komentet mbi manaxhimin e rrezikut financiar (shiko shënimin 4).

Fonde për humbjet nga zhvlerësimi i kredive

Aktivet e kontabilizuara me koston e amortizuar rishikohen për zhvlerësim në bazë të politikave kontabël të përshkruara në 3(f)(vii).

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të caktuar zhvlerësimin në baza mujore. Në përcaktimin nëse duhet të njihet në të ardhura dhe shpenzime, një humbje nga zhvlerësimi, Banka gjykon nëse ka të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë që ka një zvogëlim të matshëm në vlerësimin e hyrjeve të ardhshme të parasë nga portofoli i të arkëtueshmeve financiare përpara se të identifikohet një ulje individuale në portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë që ka patur një ndryshim me efekt negativ në statusin e pagesës së huamarrësve në një grup, ose kushte ekonomike lokale dhe kombëtare që lidhen me mosplotësimin e aktiveve të grupit. Manaxhimi bën vlerësime, bazuar në eksperiencën e humbjes historike për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidencë objektive të zhvlerësimit, të ngjashme me ato të portofolit kur parashikon flukset e ardhshme të parasë.

8. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe pasiveve financiare, për të cilat nuk ka një cmim të vëzhgueshëm në tregut, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit sic përshkruhet në politikën kontabël 3(f)(vi). Vlera e drejtë e analizuar sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë dhe vlerës kontabël të aktiveve që nuk maten me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	2017			
	Vlera e drejtë Niveli 1	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3	Totali
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	3,517,936	3,517,936
Mudaraba - fonde investimi	-	-	50,321	50,321
Murabaha - të arkëtueshme financiare	-	-	4,039,135	4,010,307
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	-	692,981	692,975
Hua nga institucioneve financiare	-	-	217,527	217,484
Detyrime ndaj klientëve	-	-	6,293,069	6,270,941

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

8. Pëcaktimi i vlerës së drejte (vazhdim)

	2016			Totali
	Vlera e drejtë Niveli 1	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3	
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	-	2,965,941	2,965,941
Mudaraba - fonde investimi	-	-	77,404	77,404
Murabaha - të arkëtueshme financiare	-	-	3,374,428	3,325,689
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	-	-	624,347	624,061
Hua nga institucioneve financiare	-	-	171,037	170,832
Detyrime ndaj klientëve	-	-	5,195,850	5,176,179

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë llogaritë rrjedhëse në bankat e nivelit të dytë. Meqenëse këto shuma janë afatshkurtra dhe me norma variabël, vlera e tyre e drejtë konsiderohet e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Investimi në Mudaraba

Ne 31 dhjetor 2017, Banka matë vlerën e investimit me referencë çmimin e tregut sipas raporteve të vlerësuesve dhe ka njohur fond zhvleresimi prej 175,080 mijë Lek (2016: 182,630 mijë Lek) (shiko shenimin 9).

9. Paraja dhe ekuivalentët të saj

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Arka	396,392	324,516
Llogari rrjedhëse me Bankën Qendrore	(87,398)	32,888
Llogari rrjedhëse me bankat e tjera	889,994	375,604
Investime deri në tre muaj	2,318,948	2,232,933
	3,517,936	2,965,941

10. Teprica të kushtëzuara me Bankën Qendrore

Tepricat e kushtëzuara me Bankën Qendrore janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	530,747	486,424
	530,747	486,424

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë lidhur me rezervën e detyruar, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve në Shqipëri, me Bankën e Shqipërisë si një llogari rezerve e detyrueshme, e cilat gjatë muajit mund të ulet deri në 60% të këtij niveli, duke siguruar që të ruhet mesatarja mujore.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

11. Investimet me bankat dhe institucionet financiare

Investimet me bankat dhe institucionet financiare:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Investime me afat	-	234,253
	-	234,253

Investimet me afat përfaqësojnë fondet me maturitet më shumë se tre muaj, të investuara nga Banka nëpërmjet bankave dhe institucioneve financiare, kryesisht si agjentë të Bankës. Agjentët investojnë fondet e Bankës në instrumenta të zgjedhura prej tyre, duke përfshirë artikuj gjerësisht të tregtueshëm dhe paguajnë fitimin e gjeneruar aty, sipas kthimit të investimit, vlerësuar në përputhje me ofertën bërë Bankës, për çdo investim. Investimet me afat janë me bankat jo-rezidente që operojnë sipas parimeve islamike, me maturitet kontraktual deri në 1 vit, bazuar në kontratat Wakala ose marrëveshje investuese.

12. Mudaraba – fond investimi

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mudaraba – fond investimi	225,402	260,034
Pakësuar me zhvlerësim për humbje	(175,080)	(182,630)
	50,322	77,404

Banka ka investuar në një fond investimi Islamik që vepron në bazë të një marrëveshje Mudaraba të përbashkët midis investitorit dhe Shoqërisë Islamike të Investimeve të Gulf (‘Mudarib-i’). Investitorët ndajnë fitimin nga operacionet që nuk e kanë arritur ende fazën finale të shlyerjes, deri në likuidimin e këtij fondi special. Sipas kësaj marrëveshje, Banka ka kushtëzuar përdorimin e fondeve vetëm për qëllim investimi në Portofolin e Pasurive të Paluajtshme Europiane (PPPE). Ky portofol përfshin katër pasuri të vendosura në qendër të Brukselit, Belgjikë dhe në Gjermani.

Bazuar në raportin e investitoreve dërguar nga Mudarib-i, kriza ekonomike europiane ka ndikuar ndjeshëm në vlerën e asetëve të PPPE dhe në mundësinë për rifinancim, qiradhënie ose shitjen e tyre, si rezultat Mudarib ka vendosur shitjen e pronave. Në bazë të këtij raporti dy prona janë shitur ndërsa ndërsa prona tjetër është në proces përfundimi të shitjes. Banka vlerëson pjesën e saj të humbjes, në përpjestim me investimin e saj në totalin e fondit fillestar të investimit. Raporti i fundit tregon një vlerë investimi për UBA në shumën 791,092 USD dhe që investimi në "Eden Blue" është në proces shitjeje dhe të ardhurat e shitjes bazohen në vlerësimet dhe pritjet të arketohen në gusht 2018.

Bazuar në këtë vlerësim, Banka ka njohur një fond zhvlerësimi për këtë investim prej 175,080 mijë Lek në 31 dhjetor 2017 (2016: 182,630 mijë Lek). Levizjet në fondin e zhvlerësimit janë si më poshtë:

	2017	2016
Teprica në 1 janar	(182,630)	(153,176)
Shpenzimi neto për vitin	(17,683)	(19,351)
Efekti i kursit të kembimit	25,233	(10,103)
Teprica në 31 dhjetor	(175,080)	(182,630)

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

13. Bono thesari të mbajtura deri në maturim

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Vlera nominale e bonove te thesarit	-	-
Zbritje e paamortizuar	-	-
	-	-

14. Murabaha – të arkëtueshme financiare

Gjendjet e të arkëtueshmeve financiare Murabaha më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme financiare me kosto të amortizuar	4,184,094	3,540,824
Të ardhura të përlogaritura	57,166	61,046
Fondi i zhvlerësimit për rënie në vlerë	(230,953)	(276,181)
	4,010,307	3,325,689

Të përfshira në të arkëtueshmet financiare Murabaha ka qira financiare në shumën neto prej 174,537 Lek (31 dhjetor 2016: 135,839 Lekë), e cila shpjegohet me tej më poshtë:

Të ardhura e përlogaritura nga huatë me probleme më 31 dhjetor 2017 janë në vlerën 41,376 mijë lek (2016: 46,173 mijë lek).

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit për rënie në vlerë është si më poshtë:

	2017	2016
Teprica më 1 janar	276,181	332,967
Shpenzime për zhvlerësimin neto nga rimarrjet	(10,923)	(52,613)
Kredi të fshira gjatë vitit	(26,081)	(5,656)
Efektet nga kurset e këmbimit	(8,224)	1,483
Teprica më 31 dhjetor	230,953	276,181

Të përfshira në të arkëtueshme financiare Murabaha ka zëra të qirasë financiare të arkëtueshmeve në të cilat Banka është qiradhënësi

	Pagesat minimale të qirasë		Vlera aktuale e pagesave minimale të qirasë	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Qira financiare të arkëtueshmeve - bruto	247,880	271,854	183,109	195,423
Vlera aktuale e pagesave minimale të qirasë	247,880	271,854	183,109	195,423
Minus të ardhurat financiare të pafituara	(65,302)	(76,311)	n/a	n/a
Provizioni për pagesat e pambledhshme të qirasë financiare	(8,041)	(59,704)	(8,041)	(59,704)
Totali	174,537	135,839	174,537	135,839

Llogaritë e arkëtueshme të qirasë financiare përfaqësojnë kolateralin e ekzekutuar nga klientët e që nuk kanë shlyer detyrimet sipas afateve dhe janë dhënë me qira palëve të treta kundrejt një skeduli ripagimi të rënë dakord. Norma e interesit ndryshon nga 3% në 5% dhe ka një maturitet kontraktual nga 10 deri në 15 vjet. Vlera e drejtë e pagesave minimale të qirasë më 31 dhjetor 2017 është 182,655 mijë lekë (2016: 193,576 mijë lekë).

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat ne '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

15. Aktive të marra nga proceset ligjore

Aktivitet e marra nga proceset ligjore përfaqësojnë prona të marra nga ekzekutimi i kolateralit të llogarive të arketueshme financiare. Keto aktive u klasifikuan si aktive të vlefshme për shitje dhe u maten me vlerë të drejte.

Në 2017, asnjë nga aktivitet e marra nga proceset ligjore nuk përmbushte detyrimin e aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje dhe si rezultat Banka i ka klasifikuar këto aktive si inventarë të mbajtura me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto së realizueshme. Ky transferim aplikohet në mënyrë prospektive.

Matja e vlerës së drejte – Hierarkia e vlerës së drejte

Vlera e drejte e këtyre aktiveve është vendosur nga vleresuesit e pronave, të cilët kanë kualifikim profesional dhe eksperiencë të kohëve të fundit lidhur me vendin dhe kategorinë e pronës që vlerësohet. Vleresuesit masin vlerën e drejtë për pronat në portofolin e Bankës çdo vit që pason vitin në të cilin ato janë marre në pronësi.

Megjithatë pronësia i është transferuar Bankës, ndonjë pronë është ende në përdorim nga huamarrësi, deri në gjetjen e blerësit potencial. Banka nuk ka synim të realizojë fitim nga dhënia me qira e këtyre pronave, por ka pranuar t'i japë me qira me qëllim mirëmbajtjen dhe ruajtjen e kushteve fizike aktuale.

Te ardhurat totale të fituara nga qiraja në vitin 2017 ishin 267 mijë Lek (2016: 34 mijë Lek).

Vlera e drejte e pronave të investuara nga Banka është kategorizuar në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë.

Niveli 3 i vlerës së drejte

Tabela e mëposhtme tregon lëvizjet nga tepricat e fillimit deri në ato të mbylljes lidhur me vlerën e drejtë të pronave të marra nga proceset ligjore.

	2017	2016
Teprica në 1 Januar	236,518	236,483
Të marra gjatë vitit	82,720	35,731
Të shitura gjatë vitit	-	(34,879)
Transferim në Qira Financiare	(34,227)	-
Ndryshimi neto i vlerës së drejtë nga zhvlerësimi	-	-
Ndryshimi neto i vlerës së drejtë nga kursi i këmbimit (e përealizuar)	597	(817)
Teprica më 31 Dhjetor	285,608	236,518

Teknikat e vlerësimit dhe të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme

Në njohjen fillestare, për matjen e vlerës së drejtë të një prone, Banka kryesisht i referohet ankandit përfundimtar lidhur me ekzekutimin, i cili rezulton në transferimin e pronësive në emër të Bankës.

Bazuar në legjislacionin lokal vlera e drejtë e këtyre pronave matet nga vlerësues të pavarur që i japin këto vlera zyrtare përmbarimore me fillimin e procedurave të ankandit. Vlera e drejtë që matet duke ju referuar cmimeve të tregut përdoret si ofertë fillestare në ankandin e parë dhe kjo ofertë mund të ulet deri në 64% të vlerës fillestare, në rast se ankandi nuk përfundon me shitjen tek një pale e tretë. Në rast se asnjë blerës nuk është paraqitur në ankandin përfundimtar me ofertën finale të reduktuar, atëherë pronësia i transferohet Bankës.

Bazuar në vlerësimet më të fundit të bëra në vitin 2015, vlera e tregut e këtyre pronave e kalon vlerën e ankandit përfundimtar. Megjithatë, duke u nisur nga kushtet aktuale të tregut dhe mungesa e ofertave gjatë ankandit dhe më pas, Drejtuesit kanë vendosur të përdorin vlerën e ulur deri në 64% të vlerësimit, e cila përfaqëson ofertën e ankandit të fundit, dhe nuk e kanë rritur vlerën e drejtë, mbi vlerën ekzistuese kontabël, nderkohe kanë provigjonuar pronat që janë zhvlerësuar.

Banka e Bashkuar e Shqiperise Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat ne '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

16. Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara

Kosto	Ndërtesa	Pajisje zyre	Kompjuterat dhe pajisje kompjuterike		Automjete	Mobilje dhe pajisje	Aktive të patrupëzuara	Aktive ne proces	Totali
			pajisje	pajisje					
Më 1 janar 2016	282,846	58,672	49,168	16,502	21,439	48,967	760	478,354	
Shtesa	-	112	9,395	-	315	-	-	9,822	
Pakesime - Nxjerje jashte perdorimit	-	-	-	(1,872)	-	-	(760)	(2,632)	
Më 31 dhjetor 2016	282,846	58,784	58,563	14,630	21,754	48,967	-	485,544	
Shtesa	-	174	1,423	6142	139	1509	-	9,387	
Pakesime - Nxjerje jashte perdorimit	-	-	(94)	-	-	-	-	(94)	
Më 31 dhjetor 2017	282,846	58,958	59,892	20,772	21,893	50,476	-	494,837	
<i>Amortizimi i akumuluar</i>									
Më 1 janar 2016	(98,996)	(55,451)	(40,161)	(16,502)	(21,367)	(47,397)	-	(279,874)	
Zhvleresimi për vitin	(15,726)	(1,570)	(4,614)	-	(37)	(612)	-	(22,559)	
Pakesime - Nxjerje jashte perdorimit	-	-	-	1,872	-	-	-	1,872	
Më 31 dhjetor 2016	(114,722)	(57,021)	(44,775)	(14,630)	(21,404)	(48,009)	-	(300,561)	
Zhvlerësimi per vitin	(14,174)	(856)	(5,415)	(808)	(97)	(542)	-	(21,892)	
Pakesime - Nxjerje jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-	-	
Më 31 dhjetor 2017	(128,896)	(57,877)	(50,190)	(15,438)	(21,501)	(48,551)	-	(322,453)	
<i>Vlera e mbetur</i>									
Më 1 janar 2016	183,850	3,221	9,007	-	72	1,570	760	198,480	
Më 31 dhjetor 2016	168,124	1,763	13,788	-	350	958	-	184,983	
Më 31 dhjetor 2017	153,950	1,081	9,702	5,334	392	1,925	-	172,384	

Më 31 dhjetor 2017 vlera bruto e aktiveve që janë amortizuar plotësisht ishte 1,517 mijë Lek (2016: Lek 3,997 mijë Lek).

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

17. Aktive te tjera

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të parapaguara	4,374	3,659
Aktive të ndryshme	11,652	10,104
	16,026	13,763

18. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogarite rrjedhëse	94,410	2,824
Depozita me afat	598,502	620,624
Pjesa e përllogaritur për shpërndarje e fitimit	63	613
	692,975	624,061

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, depozitat me afat përfaqësojnë depozitat nga Institucionet Financiare brenda Shqipërisë, me një maturitet të mbetur nga një në tre muaj.

Huaja nga IDB ne 31 Dhjetor 2016 perfaqeson huanë e marre nga IDB me qëllim pagesën e tarifës së konsulencës dhënë nga Bosna Bank International (BBI), palë e lidhur. Kjo hua u pagua ne 18 Shtator 2017.

19. Hua nga institucionet financiare.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua nga International Commercial Bank (ICB)	217,460	-
Hua nga First Investment Bank - Albania sha	-	135,230
Hua nga IDB	-	35,602
Pjesa e përllogaritur për shpërndarje e fitimit	24	-
	217,484	170,832

Më 28 dhjetor 2017, banka mori nga ICB një hua prej 800,000 EURO dhe 1,000,000 USD me afat maturimi përkatësisht më 4 janar 2018 dhe 20 janar 2018. Interesi paguhet në datën e maturimit. Norma e interesit është 0.1% vjetore për Euro dhe 0.8% vjetore për USD. Huazimet e IDB përfaqësojnë financimin e marrë nga IDB me qëllim të pagesës së tarifave të konsulencës për Bosna Bank International (BBI), një palë e lidhur. Kjo huamarrje u shlye plotësisht më 18 shtator 2017.

20. Detyrime ndaj klienteve

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari rrjedhëse	1,774,182	1,322,922
Depozita investimi	4,450,031	3,817,224
Pjesa e përllogaritur për fitim te klienteve	38,521	32,397
Llogari të tjera të klientëve	8,207	3,636
Totali	6,270,941	5,176,179

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

20. Detyrime ndaj klienteve

Llogarite rrjedhese më 31 dhjetor 2017 perfshijne një balancë prej 503 milionë Lek (2016: 91 milion Lek), që përfaqëson shumat e bllokuara nga autoritetet rregulluese ose nga banka. Disa teprica nuk janë të vlefshme për përdorim nga ana e klientëve, pa aprovimin e autoriteteve. Fondet nën manaxhim lidhen me depozitat me afat që i përkasin klientëve (referoju shënimin 16) për të cilat Banka ka marrë përgjegjësinë manaxheriale. Klientët marrin përsipër riskun e investimit që lind nga investimi i këtyre fondeve. Detyrimet me dhe pa afat ndaj klientëve sipas monedhave janë si mëposhtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari rrjedhëse:		
Në USD	422,088	306,955
Në ALL	394,423	468,903
Në EUR	922,361	512,067
Në GBP	35,310	34,997
	1,774,182	1,322,922

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Depozita me afat:		
Në USD	288,352	210,136
Në EUR	1,669,959	1,454,881
Në ALL	2,491,720	2,152,207
	4,450,031	3,817,224

Detyrime ndaj klienteve e detajuar sipas segmenteve të biznesit sipas 31 dhjetorit 2017 dhe 31 dhjetorit 2016 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Korporata	1,652,084	892,574
SME	7,816	14,493
Individë	4,572,520	4,236,715
Pjesa e përllogaritur për shpërndarje e fitimit	38,521	32,397
Total	6,270,941	5,176,179

21. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të përllogaritura	4,691	3,832
Pagesa në tranzit	21,957	15,459
Detyrime të tjera ndaj të tretëve	28	30
Fond provigjione të tjera	13,811	8,218
Detyrime të tjera	5,968	3,247
	46,455	30,786

Pagesat më 31 dhjetor 2017 përfaqësojnë transfertat në nisje në tranzit, për të cilat Banka ka vepruar si ndërmjetëse. Lëvizjet në fondet e zhvleresimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Teprica në 1 janar	8,218	6,418
Shpenzimi i vitit, neto nga rimarrjet	5,593	1,846
Efekti i kursit të kembimit	-	(46)
Teprica në 31 dhjetor	13,811	8,218

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

22. Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar

Kapitali i rregjistruar është 1,762,717 mije Lek (ekuivalent i 13,144 mije USD), i ndarë në 547,421 aksione me vlerë nominale 3,220.04 Lek (USD 24.01) për aksion. Gjatë vitit 2016 dhe 2017 nuk ka patur lëvizje në kapitalin e rregjistruar.

Rezervat

Rezervat prej 109,033 mije Lek (2016: 97,929 mije Lek) janë krijuar në përputhje me Nenin 8 të Vendimit Nr. 51, të datës 22 prill 1999 të Bankës së Shqipërisë, që kërkon kapitalizimin e 20% të fitimit neto të vitit, me Nenin 213 të Ligjit Nr. 7638, të datës 19 Nentor 1992 "Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare" që kërkon kapitalizimin e 5% të fitimit neto, dhe Statutit të Bankës, që kërkon kapitalizimin e 10% të fitimit neto të vitit.

23. Të ardhura nga operacionet bankare

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga operacionet Murabaha	197,185	188,055
Te ardhura nga bankat dhe institucione te tjera financiare	41,656	41,426
Të ardhura nga Bonot e Thesarit të mbajtura deri në maturim	-	1,344
	238,841	230,825

Fitimi nga kreditë që nuk performojnë është 19,027 mijë LEK (2016: 11,891 mijë LEK)

24. Shpenzime për shpërndarjen e fitimit për depozituesit

Shpenzimet për shpërndarjet për depozituesit janë 55,595 mije Lek (2016: 47,649 mije Lek) dhe përfaqësojnë shpërndarjen e pjesës së fitimit nga transaksionet Mudarabah, neto prej komisionit Mudarib.

25. (Humbja)/Fitim neto nga këmbimi valutor

Fitimi neto nga këmbimi valutor përfaqëson efektin e ndryshimit në kurset e këmbimit valutor në rivlerësimin e fund-vitit të pozicioneve në monedhë të huaj të Bankës dhe fitimin dhe humbjen nga transaksionet në monedhë të huaj. Banka ka realizuar fitim prej 11,530 mije Lek nga transaksionet e këmbimit valutor (në 2016: 22,156 mije Lek) dhe fitim nga rivlerësimi i pozicionit neto të vlerave monetare të bilancit për shumën 205,643 mijë lek (në 2016: humbje 21,347 mijë lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitime te parealizuara nga shkembimet valutore	22,362	28,403
Fitime te realizuara nga shkembimet valutore	23,788	33,533
Nëntotali	46,150	61,936
Humbje te parealizuara nga shkembimet valutore	(228,009)	(7,055)
Humbje te realizuara nga shkembimet valutore	(12,259)	(11,378)
Nëntotali	(240,268)	(18,433)
Totali	(194,118)	43,503

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

26. Shpenzime të personelit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Staf i huaj	17,208	18,939
Stafi vendas	80,131	74,707
Sigurime shoqërore	11,232	10,511
Të tjera kosto dhe shpërblime	883	2,573
	109,454	106,730

27. Shpenzime të tjera administrative

Shpenzime të tjera administrative përfshijnë sa më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Sherbime ligjore, konsulence dhe auditimi	17,203	9,234
Shpenzime zyre	22,717	16,410
Sigurimi i depozitave	15,502	13,758
Shpenzime sigurimi	12,066	11,573
Swift, Reuters dhe lidhjet në rrjet	12,276	12,397
Mirëmbajtje software	11,377	11,483
Bordi i Drejtoreve dhe Komiteti i Auditimit	5,076	6,604
Tarifa, taksa dhe detyrime	3,312	2,949
Telefon dhe poste	1,506	1,574
Udhëtime dhe transport	1,829	1,191
Marrëdhënie me publikun dhe përfaqësime	8,659	3,683
Shpenzime të tjera	114	(50)
	111,637	90,806

28. Tatim fitimi

Banka përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin Shqiptar mbi taksat. Tatimi mbi të ardhurat ka një normë tatimore prej 15% (2016: 15%) të të ardhurave të tatueshme. Tatimi mbi fitimin përpara taksave ndryshon nga shuma teorike që mund të lindte duke përdorur normën bazë të taksës si më poshtë:

	Norma e tatimit	2017	Norma e tatimit	2016
(Humbja)/Fitim përpara tatimit		(163,246)		42,353
Tatimi i llogaritur me normën tatimore 15% (A)	(15%)	(24,487)	15%	6,353
Ndikimi në takse nga shpenzime e panjohura (B)	3%	5,822	12%	4,954
Humbje tatimore të panjohura (C)		18,665		-
Shpenzimi tatimor/ Norma efektive e taksimit	(12%)	-	27%	11,307

Në 2017, Banka ka kryer parapagime të tatim fitimit 4,400 mijë Lek (2016: zero). Tatimi i parapaguar në 31 Dhjetor 2017 ishte 11,050 mijë Lek (2016: 6,651 mijë Lek). Në bazë të ligjit vendas të kontabilitetit, duke filluar nga 1 janari 2008, Banka duhet të raportojë në përputhje me SNRF-të. Në vazhdim, Ligji Nr. 10364, të datës 16.12.2010 sjell disa amendime të vecanta (efektive nga 24 janari 2011). Bazuar në këto amendime, fondet e zhvlerësimit sipas SNRF-ve duhet të konsiderohen si shpenzim i zbritshëm tatimor, duke siguruar që ato janë të certifikuar nga auditorët e jashtëm dhe nuk kalojnë limitet e përcaktuara nga Banka Qendrore. Duke filluar nga 1 Janari 2014, limitet e përcaktuara nga Banka Qendrore nuk janë të zbatueshme dhe provigjoni i njohur në përputhje me SNRF konsiderohet si shpenzim i zbritshëm për efekt tatimi. Si rezultat i këtyre ndryshimeve në legjislacion, nuk ka më diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël dhe vlerës së tatueshme të aktiveve financiare në 31 dhjetor 2017.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

29. Angazhime dhe detyrime të tjera të mundshme

Garancitë dhe letrat e kreditit

Garancitë	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
	52,106	27,091

Banka lëshon garanci për klientët e saj. Këto instrumenta bartin një rrezik kreditimi, të ngjashëm me të arkëtueshmet financiare. Bazuar në vlerësimin e manaxhimit, nuk do të ketë humbje materiale për vlerat e garancive me 31 dhjetor 2017, dhe kështu, nuk ka ndonjë provigjon të përfshirë në këto pasqyra financiare për këtë arsye.

Cështje ligjore

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, Banka përballet me pretendime ligjore; manaxhimi i Bankës është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet ligjore më 31 dhjetor 2017.

Angazhimet e qirasë

Banka ka hyrë në angazhime jo-të anulueshme qiraje për të gjithë degët e saj. Angazhime të tilla, për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Më pak se një vit	14,101	18,453
Midis një viti dhe pesë viteve	26,750	36,634
	40,851	55,087

Banka ka kontata qiraje për të gjitha degët.

30. Transaksionet me palët e lidhura

Banka hyn në transaksione me aksionarët e saj gjatë rrjedhës normale të biznesit. Teprica kryesore me aksionerët në minorancë dhe palët e lidhura janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktive		
Investime me banka dhe institucione financiare	896,492	415,756
Mudaraba – fonde investimi	225,402	252,829
Provigjone Mudaraba - fonde investimi	(175,080)	(175,425)
Aktivite financuese	-	-
Provigjoni për aktivite financuese	-	-
Detyrimet		
Detyrime ndaj klienteve- aksionerve	9,696	11,138
Detyrime ndaj Bosna Bank International d.d	-	-
Hua nga IDB (detyrime ndaj aksionereve)	-	(35,602)

Tepricat e paraqitura më lart janë me aksionerët që zoterojnë më pak se 5% të kapitalit aksioner të Bankes dhe nuk janë konsideruar si të lidhura në përputhje me Nenin 64 të Ligjit mbi Bankat për maksimumin e ekspozimit me palët e lidhura.

Palet e lidhura janë të përcaktuara në përputhje me Nenin 4 “Perkufizimet”, paragrafet 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 9662, i datës 18 dhjetor 2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”. Ekspozimi maksimal me palët e lidhura është i monitoruar për përputhshmëri me Nenin 64 të këtij Ligji

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat në '000 Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

30. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me drejtorët

Shpërblimi i drejtorëve është i përfshirë në shpenzimet e personelit. Ai detajohet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat	15,901	16,280
Bonuset dhe shpërblime të tjera	1,505	-
Shpërblimi i Bordit të Drejtorëve	4,363	3,896
	21,769	20,176

Të ardhurat dhe shpenzimet që lindin nga transaksionet me palët e lidhura janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga filialet e Dallah Holding	7,178	2,480
Sherbime konsulence (BBI)	-	-
Shpenzimet për shpërndarje për depozituesit	(52)	(78)

31. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit, që do të mund të kërkonte rregullime dhe shpjegime të tjera shtesë në pasqyrat financiare